

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për censin e bujqësisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Përafrim i pjesshëm me Rregulloren Evropiane (BE) 2018/1091 “Statistikat e Integruara të Fermës”
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendimi nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027” Programi Qeverisës 2021-2025 Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Nga data 30.7.2025 deri më datë 27.8.2025 perfundimi.
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	8 tetor 2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 26.6.2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 - MBZHR- Nr. 5
TË DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Adra Gjongecaj E-mail: Adra.Gjongecaj@bujqesia.gov.al Numri i telefonit: 0692325402 Eneida Sokoli E-mail: Eneida.Sokoli@bujqesia.gov.al Numri i telefonit: 0695612584 Julinda Bare E-mail: Julinda.Bare@bujqesia.gov.al Numri i telefonit: 0692079453 Elda Tahiraj E-mail: Elda.Tahiraj@bujqesia.gov.al Numri i telefonit: 0696680165

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

(Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Krijimi i një baze informacioni të përgjithshëm dhe të hollësishëm për të gjitha njësitë ekonomike bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në fushën e bujqësisë, do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, në përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj, krijimin e regjistrit statistikor të njësisë ekonomike bujqësore dhe përgjithësimin e rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga EUROSTAT.

Mungesa e informacionit, saktësia dhe vërtetësia e tij kanë sjellë domosdoshmërinë e ndërmarrjes së angazhimit nga qeveria shqiptare për përmirësimin e treguesve statistikorë zyrtarë, të prodhuar nga sistemi kombëtar statistikor dhe rritjen e imazhit të prodhuesve të statistikave zyrtare, veçanërisht INSTAT-it duke e strukturuar atë në një institucion profesionalisht të pavarur (*Programi i Qeverisë 2013, “Statistikat”, VKM-ja nr. 650, datë 10.11.2017 “Për angazhimin e Qeverisë Shqiptare në besueshmërinë në statistika”*).

Ndërkohë, projektligji është i domosdoshëm për të siguruar kryerjen e aktivitetit “Censi i Bujqësisë”, parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022 - 2026, miratuar me Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”.

Në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2024 - 2026 është parashikuar harmonizimi i legjislacionit për Censin e Bujqësisë duke përafruar pjesërisht Rregulloren Evropiane (BE) 2018/1091 “Statistikat e Integruara të Fermës” në katërmujorin e parë, të vitit 2024.

Problematikat e evidentuara kanë përgjithësisht natyrë rregullatore dhe paraqiten si më poshtë:

- Mungesë e kuadrit ligjor të posaçëm për marrjen dhe administrimin e informacionit në fushën e bujqësisë;
- Mungesë e besueshmërisë nga ana e përdoruesve të statistikave zyrtare;
- Domosdoshmëria e plotësimit të parashikimeve të Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026, miratuar me Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”;
- Përafrimi i kuadrit ligjor të brendshëm me *acquis communautaire*, direktivat e BE-së.
- Mungesë e koherencës dhe saktësisë së treguesve statistikorë në bujqësi.

1. *Mungesë e koherencës dhe saktësisë së treguesve statistikorë në bujqësi.*

- Censi më i fundit i bujqësisë është zhvilluar në vitin 2012. Censi i ri do të mundësojë përditësimin e statistikave në fushën e bujqësisë me cilësi dhe në përputhje me kërkesat e EUROSTAT-it;
- Regjistri administrativ i fermave është një bazë jo e konsoliduar të dhënash gjë që ndikon në cilësinë statistikore;
- Përmirësimi i harmonizimit dhe koherencës së statistikave bujqësore evropiane.

2. Mungesë e kuadrit ligjor të posaçëm për marrjen dhe administrimin e informacionit në fushën e bujqësisë.

- o Mungesë e të dhënave të sakta në fushën e bujqësisë, reale, në kohë duke ofruar produkt përfundimtar të besueshëm dhe eficient për përdoruesit;
- o Mosplotësim në mënyrë e duhur të nevojave të reja për të dhëna si pasojë e mospërfshirjes së metodave moderne evropiane, si parashikime në akte ligjore, qëllimit për realizimin e një baze stabël të të dhënave statistikore në fushën e bujqësisë;
- o Mungesë e fleksibilitetit legjislativ dhe të integruar sa duhet për t'iu përgjigjur nevojave në fushën e bujqësisë.

3. Mungesë e besueshmërisë nga ana e përdoruesve të statistikave zyrtare.

Një nga problematikat kryesore që shoqëron përdorimin e bazës së të dhënave statistikore është besueshmëria e përdoruesve në nivele të ulëta. Mungesa e produkteve të plota statistikore ndikon negativisht në besueshmërinë e përdoruesve në statistikat e prodhuara, duke ndikuar në mënyrë negative te politikëbërësit, bizneset dhe publiku i gjërë të cilët duhet të ndërmarrin vendime bazuar në prova të qëndrueshme.

4. Domosdoshmëria e plotësimit të parashikimeve të Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, miratuar me Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”.

Propozimi i nismës është në linjë me kërkesat e vazhdueshme të BE-së për prodhimin e statistikave cilësore në fushën e bujqësisë. Projektligji do të mundësojë zbatimin e censit të bujqësisë, si një prej aktiviteteve madhore të Programit të Statistikave Zyrtare. Nisma do të përcaktojë gjithashtu rregulla të hollësishme për aktorët e përfshirë në aktivitet, ku institucioni lider do të jetë INSTAT-i. Të dhënat e grumbulluara nga censi do të mundësojnë llogaritjen e treguesve të rinj bazuar në rregulloren evropiane të statistikave të blegtorisë dhe prodhimit të mishit, rishikimin dhe pasurimin e listës së prodhimeve bujqësore domethënëse për llogaritjen e indeksit të çmimeve të prodhimeve bujqësore etj.

5. Përafrimi i së BE-së në kuadrin ligjor të brendshëm.

Një tjetër çështje e rëndësishme është harmonizimi në metodologjinë e llogaritjes së treguesve, klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të EU-së, detyrë dhe kërkesë kjo e përshtatjes së vazhdueshme të mjedisit rregullator me *acquis communautaire* të BE-së sipas kushteve për t'u plotësuar për vazhdimësinë e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Mungesa e një ligji të posaçëm dhe koherent i cili edhe përafron Rregulloren (BE) 2018/1091 dhe pengon mbledhjen e të dhënave sipas metodave dhe cilësisë së duhur, nuk ofron besimin e duhur te përdoruesit e bazave të të dhënave si dhe nuk përmbush kërkesat për përshtatjen e legjislacionit më atë të BE-së.

Grupet e ndikuar janë:

- o Qeveria;
- o Operatorët e bizneseve;
- o Njësitë ekonomike bujqësore;
- o Shoqëria civile;
- o Kërkuesit shkecorë.

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të rritet eficensa e procesit të mbledhjes së të dhënave statistikore në bujqësi, ofrimi i një kuadri rregullator të qartë, efektiv, përcaktimin e saktë të zinxhirit zbatues, eliminimin e problematikës së mungesës së përafrimit të *acquis* së BE-së në fushën e bujqësisë, si dhe ofrimi i një bazë të të dhënave me cilësi të lartë duke

rritur në të njëjtën kohë besimin te publiku. Adresimi i problematikave të evidentuara do të kryhet duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, moderne, evropiane dhe të përshtatshme lidhur me zhvillimet në bujqësinë shqiptare, e cila ka rëndësi thelbësore dhe është në qendër të politikave të Qeverisë së Shqipërisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë siç vijon:

1. Të sigurohet informacion i përgjithshëm dhe i hollësishëm për të paktën 98% të sipërfaqes së shfrytëzuar nga njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe 3-vjeçare nga momenti i miratimit i nismës.
2. Të ofrohen të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor në Republikën e Shqipërisë brenda një periudhë prej 3 vitesh nga momenti i miratimit të nismës.
3. Të krijohet regjistri statistikor i njësive ekonomike bujqësore në një periudhë prej 2 vitesh nga momenti i miratimit të kësaj nisme.
4. Përafrimi i legjislacionit me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian menjëherë me miratimin e kësaj nisme ligjore.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së: Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma ligjore, nënkupton mosdhënien e një zgjidhjeje të problematikave të evidentuara, mosadresimin e tyre si dhe mosplotësimin e detyrimeve për përafrimin ligjor me *acquis communautaire* e BE-së.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual “Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore” duke dhënë zgjidhjen e duhur lidhur me problematikat të cilat janë evidentuar. Ky opsion është i përshtatshëm, trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, duke dhënë rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë. Përzgjedhja e këtij opsioni bën sigurimin që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standardet evropiane dhe në të njëjtën kohë përmbushin detyrimin për përafrimin e BE-së, si dhe harmonizimin me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi. Nga ana tjetër, ligji i ri mundëson rregullimin e marrëdhënieve ndërinstytucionale duke patur parasysh statusin e ri të INSTAT-it si institucion publik i pavarur, në marrëdhënie me institucionet e tjera publike mbështetëse.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i ndryshimeve ligjore në ligjin aktual “Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, nuk rregullon problematikat e evidentuara në fushën e mbledhjes së informacionit në bujqësi duke mos arritur rezultatet e duhura që synohen të arrihen sipas kërkesave të BE-së por edhe nevojave të evidentuara. Përzgjedhja e këtij opsioni bën sigurimin që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standardet evropiane dhe

në të njëjtën kohë përmbushin detyrimin për përafrimin e BE-së, si dhe harmonizimin me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit ekzistues në fuqi nga strukturat kompetente. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, analizimi i terrenit më i shpeshtë etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këta sektorë. Ky opsion nuk ofron zgjidhjen e duhur për problematikat e evidentuara dhe as përmbushjen e qëllimeve që ka vënë Qeveria Shqiptare.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar është **Opsioni 1 (rregullator)**: Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual “Ligji nr.1 0201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore” jep zgjidhjen e duhur për problematikat e evidentuara. Ky opsion është i përshtatshëm, trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, duke dhënë rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë. Përzgjedhja e këtij opsioni siguron që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standardet evropiane në këtë fushë specifike, si dhe duke përmbushur detyrimin për përafrimin e *acquis communautaire* të BE-së me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi. Nga ana tjetër, ligji i ri mundëson rregullimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale duke patur parasysh statusin e ri të INSTAT-it si institucion publik i pavarur, në marrëdhënie me institucionet e tjera publike mbështetëse. Opsioni i përzgjedhur nga ana jonë parashikon investime fillestare të konsiderueshme, por pritshmëritë për ndikime afatgjata janë të larta dhe me rezultate pozitive sociale, ekonomike dhe mjedisore duke justifikuar kështu kostot. Rritja ekonomike dhe përmbushja e standardeve të BE-së pritet të kenë një ndikim pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të vendit më gjerë, duke mbështetur kështu edhe objektivat kombëtare për integrim evropian dhe mirëqenie të shtuar për shoqërinë. Për rrjedhojë, Opsioni 1 do të ketë një ndikim pozitiv në përfitueshmërinë dhe rritjen ekonomike të sektorëve të përfshirë.

Grupet e prekura:

Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

1. Qeveria:

- Përmbush qëllimet e saj për standarde evropiane dhe përafrimin e BE-së me legjislacionin e brendshëm.
- Ofron një bazë të të dhënave efektive dhe eficiente në kohë dhe përdorim të të dhënave statistikore reale të sakta.
- Plotëson standardet e BE-së për sektorin bujqësor dhe blegtorinë, duke përmirësuar imazhin ndërkombëtar.
- Modernizimi i sektorit të bujqësisë duke ofruar një bazë solide, të gjerë të të dhënave mbi sektorët e bujqësisë.
- Rrit besueshmërinë e publikut të statistikave zyrtare.
- Vlerësim i duhur i gjendjes së sektorit të bujqësisë në vend.

2. Fermerët:

- Paisje me çdo informacion të nevojshëm në kohë reale pa kosto.

- Përfitime gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre bujqësore, zgjerimi i veprimtarive, ushtrimi i tregtisë etj. si shkak i informacionit të menjëhershëm dhe eficient që i shërbejnë interesave të tyre.

3. Komuniteti dhe shoqëria civile:

- Përfitime sociale përmes modernizimit të sektorit bujqësor.
- Shfrytëzimi i të dhënave për nevojat e tyre me ndikim pozitiv, përmirësimi i jetesës në zonat rurale.
- Modernizimi i bujqësisë dhe diversifikimi i aktiviteteve në zonat rurale krijon bazën për një bujqësi të qëndrueshme në vend.
- Përforsimi i forcës së punës nga aktivitete të lidhura me bujqësinë drejt atyre jobujqësore. Përmirësimi i standardeve në sektorin rural krijon mundësi punësimi përmes diversifikimit dhe zhvillimit të mundësive për gjenerimin e të ardhurave në sektorin e bujqësisë.

4. Punëmarrësit:

- Mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi profesional.
- Lehtësi në mbarëvajtjen e tyre në zhvillimin e biznesit me rezultate në zgjerimin e aktivitetit ekonomik e për rrjedhojë rritjen e nevojës për punësime të reja.
- Përmirësim i kushteve të punës dhe hapje e vendeve të punës në zonat rurale.

Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të hartimit të projektligjit të ri:

1. Ndikimet Sociale:

Hartimi i projektligjit “Për Censin në Bujqësi” do të krijojë një bazë të dhënash të plotë dhe të përditësuar për sektorin bujqësor, duke mundësuar planifikimin dhe zbatimin më efektiv të politikave kombëtare në përputhje me standardet e BE-së. Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore do të jenë të tërthorta dhe varen nga mënyra se si këto të dhëna do të përdoren për të përmirësuar politikat, investimet, standardet dhe partneritetet tregtare.

1. Punësimi dhe kushtet e punës

- Të dhënat mund të ndihmojnë qeverinë të identifikojë nevojat për trajnim profesional të fermerëve dhe punonjësve sezonalë.
- Mund të përmirësojnë targetimin e skemave të mbështetjes për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale.
- Mund të nxiten politika që mbështesin punësimin formal, duke ndihmuar që punonjësit të dalin nga informaliteti.

Në vetvete censusi nuk gjeneron vende pune, por ndihmon politikat që i gjenerojnë.

2. Ndikime ekonomike indirekte

a) Rritja e standardeve të prodhimit dhe përpunimit

- Duke pasur të dhëna më të sakta, shteti mund të hartojë politika standardizimi, certifikimi dhe të sigurisë ushqimore.
- Operatorët ekonomikë mund të përdorin të dhënat për analiza tregu, identifikim tregjesh të reja dhe plane investimi.

b) Partneritete dhe tregje të reja

- Institucionet mund të përdorin të dhënat për të negociuar marrëveshje tregtare ose për të përafruar standardet me BE-në.

- Bashkëpunimi ndërkombëtar lehtësohet sepse të dhënat statistikore janë një “*valutë besueshmërie*” për investitorë të huaj.

c) Përdorimi i të dhënave për tërheqjen e investimeve

- Bizneset mund të analizojnë të dhënat për të parë ku ka potencial për zhvillim, kultura bujqësore, infrastrukturë ujëtare apo përpunim, agro-turizëm.

3. Ndikime mjedisore indirekte

a) Politika më të sakta për mbrojtjen mjedisore

- Të dhënat ndihmojnë në monitorimin e përdorimit të pesticideve, fertilizuesve dhe ujit.
- Mund të orientojnë politikat për bujqësi të qëndrueshme dhe praktika të agro-bujqësisë.
- Mund të mbështesin plane për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

4. Ndikime për administratën publike

a) Menaxhim më i mirë i burimeve financiare

- Shteti mund të alokojë fondet e subvencioneve, grantet dhe mbështetjen financiare bazuar në të dhëna reale, jo në supozime.
- Zvogëlohet abuzimi apo shpërdorimi i skemave të mbështetjes.

5. Harmonizim me standardet e BE-së

- Të dhënat i japin mundësi Shqipërisë të raportojë sipas standardeve EUROSTAT dhe FAO, që është kusht për politikat e përbashkëta bujqësore në kuadër të integritetit.

Të gjitha këto ndikime janë indirekte, sepse ato varen 100% nga përdorimi:

- Nëse të dhënat nuk përkthehen në politika, nuk ka ndikim real.
- Nëse qeveria nuk i përditëson, nuk i analizon dhe nuk i shpërndan te aktorët relevantë, nuk gjenerohet vlerë.
- Nëse bizneset nuk i përdorin për planifikim tregu, nuk sjellin rritje konkurruese.

4. Kosto dhe Përfitime

a) Kosto të drejtpërdrejta në sektorin publik:

- o Censusi kërkon fonde të mëdha për organizimin, trajnimin e anketuesve, teknologji, logjistikë dhe analizë të të dhënave të cilat janë përlllogaritur në shumë totale 800 milion lekë.
- o Angazhohen një numër i konsiderueshëm punonjësish të administratës dhe specialistësh për një periudhë të gjatë.
- o Menaxhimi i saktë i procesit është sfidues, sidomos në zona të thella rurale apo me akses të kufizuar.

Përfitime ekonomike të sektorit publik: Megjithëse ka disa kosto, përfitimet afatgjata të censusit të bujqësisë në Shqipëri i tejkalojnë dukshëm këto kosto, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Të dhënat e përfuara ndihmojnë në modernizimin e sektorit bujqësor, në rritjen e konkurrueshmërisë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm rural.

- o Qeveria merr një pasqyrë të qartë mbi strukturën e bujqësisë (sipërfaqet e mbjella, numrin e fermave, përdorimin e tokës, mekanizimin, fuqinë punëtore, etj.);
- o Harton politika bujqësore më të sakta dhe efektive;

- Të dhënat ndihmojnë për të planifikuar investime publike në infrastrukturë rurale, ujitje, subvencione apo skema mbështetjeje;
- Censusi zhvillohet sipas standardeve të EUROSTAT, çka ndihmon Shqipërinë në procesin e integritimit evropian;
- Mundëson zhvillimin e politikave të synuara për zona të caktuara ku bujqësia ka potencial të lartë apo ku ka nevojë për ndërhyrje. *Kostot e drejtpërdrejta për sektorin privat:*

b) *Kosto të drejtpërdrejta të sektorit privat:* nuk paraqiten kosto ekonomike për përdoruesit e bazës së të dhënave sipas parashikimeve të kësaj nismë.

Kosto jo të drejtpërdrejta në sektorin privat: identifikohen disa kosto jo të drejtpërdrejta siç janë:

- Fermerët dhe subjektet bujqësore duhet të ndajnë kohë për të marrë pjesë në anketë, gjë që mund të ndërpresë aktivitetet e tyre ditore.
- Disa fermerë mund të kenë rezerva për të ndarë informacion mbi prodhimin apo të ardhurat e tyre, duke rritur hezitimin.
- Edukimi dhe trajnimi mund të paraqesin kosto, të cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë nismë, pasi inovacionet teknologjike kërkojnë një nivel të caktuar njohurish dhe aftësish nga fermerët. Për të realizuar potencialin e plotë të teknologjive inovative në bujqësi, është e rëndësishme të investohet në edukimin e fermerëve, të mbështetet kërkimi shkencor dhe të krijohen politika që inkurajojnë adoptimin e teknologjive të reja. Prandaj, programet e edukimit dhe trajnimeve janë të domosdoshme për të maksimizuar përfitimet nga këto teknologji.

Përfitimet ekonomike për sektorin privat:

- Agrobizneset dhe fermat mund të analizojnë tregun dhe konkurrentët përmes statistikave të qarta.
- Investitorët mund të identifikojnë zona me potencial për zhvillim bujqësor apo agro-industrial.
- Bankat dhe institucionet financiare përdorin të dhënat për të zhvilluar produkte të përshtatura për sektorin bujqësor (kredi, sigurime bujqësore, etj.).
- Kompanitë që merren me shpërndarje inputesh apo tregtim produktesh bujqësore mund të targetojnë më mirë fermerët.

Qëllimi i kësaj nisme është krijimi i një panorame të plotë të sektorit bujqësor, për të ndihmuar zhvillimin e tij të qëndrueshëm, efikas dhe të orientuar drejt tregut dhe standardeve, përmes një baze ligjore e të konsoliduar. Censi i Bujqësisë do të:

- ofrojë një pasqyrë të plotë dhe të besueshme të bujqësisë shqiptare, përfshirë numrin e fermave, madhësinë e tyre, përdorimin e tokës, kulturat bujqësore, blegtorinë, mekanizimin, forcat e punës, etj.;
- krijojë një bazë të dhënash për politika dhe programe të zhvillimit rural, me qëllim planifikimin e ndërhyrjeve më të mira për të rritur prodhimin, qëndrueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e sektorit;
- sigurojë të dhëna të krahasueshme ndërkombëtarisht, në përputhje me standardet, duke ndihmuar kështu procesin e integritimit të Shqipërisë në BE;
- evidentojë ndryshimet strukturore në bujqësi gjatë viteve, duke krahasuar me censuset e mëparshme, për të mundësuar analizimin e trendeve dhe transformimeve në sektor, si dhe;

- o mbështesë sektorin privat dhe kërkimin shkencor, për analiza dhe plane konkrete.

Shpenzimet e ndara në zëra, në mënyrë të detajuar janë si vijon:

Sipas vlerësimit të kryer nga INSTAT, kostot e parashikuara për realizimin e Censurit në Bujqësi – një proces që zhvillohet një herë në çdo 10 vjet – arrijnë në një total prej 890.91 milion lekësh. Kjo shumë është e shpërndarë sipas zërave kryesorë të nevojshëm për organizimin dhe zbatimin e tij.

Shpenzimet më të madha të projektit lidhen me burimet njerëzore, që përfshijnë punonjës teknikë dhe staf mbështetës. Kjo kategori zë një vlerë prej 475.94 milion lekësh, nga të cilat 419.27 milion lekë janë planifikuar për pagesat e stafit teknik si anketues, kontrollorë, teknikë IT dhe GIS, ndërsa 27.28 milion lekë përfshijnë pagat e stafit administrativ, si specialistët e burimeve njerëzore, financës, prokurimeve dhe sektorit ligjor. Përveç pagave, janë parashikuar edhe 28.99 milion lekë për trajtimin me dieta të punonjësve që angazhohen në misione dhe udhëtime pune.

Në funksion të zbatimit dhe ndjekjes së procesit, janë planifikuar 17.13 milion lekë për udhëtime dhe monitorime, përfshirë këtu udhëtime ndërkombëtare për rritjen e kapaciteteve dhe inspektimet në terren për stafin e angazhuar.

Një tjetër zë me peshë janë shpenzimet për pajisje dhe teknologji, me një total prej 59.91 milion lekësh. Këtu përfshihen 8.72 milion lekë për blerjen apo marrjen me qira të automjeteve, 3.70 milion lekë për pajisje kompjuterike, si dhe 47.50 milion lekë për sisteme IT (hardware dhe software), të domosdoshme për menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave.

Për qiratë e ambienteve të punës janë përllogaritur 28.74 milion lekë, ndërkohë që 186.83 milion lekë janë dedikuar për një sërë aktiviteteve të tjera mbështetëse, si: *publikime, studime, kërkime, asistencë teknike, auditime, përkthime, organizim konferencash, seminare dhe aktivitete të vizibilitetit*.

Sa i takon shërbimeve logjistike dhe teknike, është parashikuar një shumë prej 47.75 milion lekësh, që përfshin shpenzime për internetin e zyrave, shërbime cloud, furnizime materiale dhe transportin e nevojshëm për realizimin e operacioneve në terren.

Në total, kostot e drejtpërdrejta të projektit përllogariten në 815.85 milion lekë, ndërsa kostot indirekte, që përfshijnë mbulimin e nevojave administrative dhe operative të përgjithshme, arrijnë në 32.63 milion lekë.

Për të përballuar situata të paparashikuara ose nevoja emergjente gjatë zbatimit të Censurit, është përfshirë një fond rezervë prej 42.42 milion lekësh. Kjo e çon koston totale të projektit në 890.91 milion lekë.

Gjatë punës për draftimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit janë marrë në konsideratë edhe dokumentet shoqëruese të Rregullores Evropiane (BE) 2018/1091 “Statistikat e Integruara të Fermës” e cila do të përafrohet pjesërisht me miratimin e propozimit të nismës që sjell Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për Censurin në Bujqësi”. Në mënyrë të veçantë përmendim këtu *Impact Assessment* i cili është dokumenti shoqërues i rregullores së sipërcituar dhe i cili është përdorur si referencë gjatë draftimit të këtij dokumenti, duke e sjellë atë në frymën e përshtatshme për mjedisin ligjor shqiptar,

në përputhje me rregullat e përafrimit të *acquis communautaire* e duke bërë kështu që konkluzionet tona të jenë në përputhje me konkluzionet e këtij dokumenti¹.

Opsioni i përzgjedhur nga ana jonë parashikon kosto fillestare të konsiderueshme, që arrijnë rreth 890 milion lekë për buxhetin e shtetit, por pritshmëritë për ndikime afatgjata janë të larta dhe me rezultate pozitive sociale, ekonomike dhe mjedisore duke justifikuar kështu kostot. Rritja ekonomike dhe përmbushja e standardeve të BE-së pritët të kenë një ndikim pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të vendit më gjerë, duke mbështetur kështu edhe objektivat kombëtare për integrim evropian dhe mirëqenie të shtuar për shoqërinë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar:

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të katër opsionet tregoi se: **Opsioni 1**, hartimi i projektligjit “Për Censin e Bujqësisë” është vlerësuar me më shumë pikë duke u zgjedhur nga ana jonë si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i “Ligjit nr. 10201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore” jep zgjedhjen e duhur lidhur me problematikat e evidentuara. Ky opsion është i përshtatshëm, trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, duke dhënë rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë.

Përzgjedhja e këtij opsioni siguron që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standardet evropiane dhe në të njëjtën kohë përmbush detyrimin për përafrimin e *acquis communautaire* të BE-së me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi. Nga ana tjetër, ligji i ri mundëson rregullimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale duke patur parasysh statusin e ri të INSTAT-it si institucion publik i pavarur, në marrëdhënie me institucionet e tjera publike mbështetëse.

Përmes propozimit të kësaj politike bëhet i mundur krijimi i një mjedisi ligjor të përshtatshëm dhe të nevojshëm për kryerjen e Censit të Bujqësisë, duke marrë në konsideratë standardet e reja ndërkombëtare të vendosura. Censi i Bujqësisë do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, në përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj, krijimin e regjistrit statistikor të njësive ekonomike bujqësore dhe përgjithësimin e rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga EUROSTAT.

Risitë që sjell që sjell kjo nismë ligjore janë:

1. Ofrimi i të dhënave të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor në Republikën e Shqipërisë;
2. Marrja e masave të nevojshme për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe metodave të transmetuara në mënyrë që kriteret e cilësisë statistikore të jenë në përputhje me parimet statistikore të përcaktuara në legjislacionin për statistikat zyrtare;

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:52016SC0430>

3. Aksesimi i INSTAT-it në listën e plotë të pronarëve të tokës, sipërfaqen në pronësi dhe adresat e vendndodhjes së tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
4. Nisma ligjore ngarkon INSTAT-in për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve për kundërvajtjet administrative të konstatuara, në respektim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjit për kundërvajtjet administrative.

Rezultatet e pritshme nga miratimi i kësaj nisme ligjore janë:

1. Harmonizimi në metodologjinë e llogaritjes së treguesve, klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të EU-së;
2. Ridizenjimi i pyetësorit të vrojtimit vjetor në bujqësi (njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale), si dhe përgatitja e kampionit të veçantë për bujqësinë dhe blegtorinë me qëllim rritjen e cilësisë;
3. Përdorimi i metodave të kombinuara të grumbullimit të informacionit statistikor nga vrojtimi dhe burimi administrativ lidhur me të dhënat për numrin e krerëve dhe prodhimet blegtorale, si dhe regjistrin administrativ të kafshëve;
4. Llogaritja e treguesve të rinj bazuar në rregulloren evropiane të statistikave të blegtorisë dhe prodhimit të mishit, si: therjet jashtë thertoreve, prodhimi i brendshëm bruto (parashikimi i mishit) etj.;
5. Rishikimi dhe pasurimi i listës së prodhimeve bujqësore domethënëse për llogaritjen e indeksit të çmimeve të prodhimeve bujqësore;
6. Rishikimi dhe pasurimi i listës së prodhimeve bujqësore domethënëse për llogaritë ekonomike në bujqësi;
7. Llogaritja e indikatorëve në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
8. Zhvillimi i Censit të Bujqësisë.

Ndërkohë, miratimi i kësaj politike që propozojmë është i domosdoshëm për të siguruar kryerjen e aktivitetit “Censi i Bujqësisë”, parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022 - 2026, miratuar me Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”.

Opsioni i përzgjedhur nga ana jonë parashikon kosto fillestare të konsiderueshme, por pritshmëritë për ndikime afatgjata janë të larta dhe me rezultate pozitive sociale, ekonomike dhe mjedisore duke justifikuar kështu kostot. Përmbushja e standardeve të BE-së në këtë fushë pritet të kenë një ndikim pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe më gjerë me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit, duke mbështetur kështu edhe objektivat kombëtare për integrim evropian dhe mirëqenie të shtuar për shoqërinë.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
890.910.0000		

Censusi i Bujqësisë do të kryhet 1 herë në 10 vite. Kostot e llogaritura nga INSTAT paraqiten në tabelën e mëposhtme, ku përfshihen kostot e shpenzimeve të personelit për punonjësit (anketues terreni, kontrollorë anketimi, operatorë, teknik të specializuar), si

dhe shpenzime operative (shërbime printimi dhe publikimi, trajnime dhe seminare, udhëtime të brendshme/dieta, shpenzime për qiramarrje të ambienteve).

KONSTULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse)?

Metodat e përdorura gjatë Konsultimit Publik janë:

Kohëzgjatja e konsultimeve publike ka zgjatur nga data 30.7.2025 deri më datë 27.8.2025, për 20 ditë pune, afat i cili përfshin konsultimin përmes Regjistrisë Elektronike. Gjithashtu, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, datë 12.9.2025 u organizua një takim me përfaqësues të INSTAT-it, hartues të draftit fillestar të projektligjit dhe përfaqësues të grupit të punës në MBZHR. Gjithashtu, pati komunikime edhe përmes postës elektronike nga grupe të interesit të përfshira në këtë proces. Numri i shikimeve në RENJKP është 337, ku pati sugjerime nëpërmjet postë elektronike.

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për Censin e Bujqësisë”, ishin:

- Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike, REKNJP, nga data 30.7.2025 deri më datë 27.8.2025;
- Takim fizik në ambientet e MBZHR-së, njoftuar përmes postës elektronike, më datë 12.9.2025;
- Komunikimi përmes postës elektronike me grupet e interesit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimin publik gjatë procesit të hartimit, janë:

1. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, komunikim përmes postës elektronike;
2. UN Women, komunikim përmes postës elektronike.

Pasqyrimi i komenteve, arsyetimi i komenteve të pranuar apo të refuzuara:

1. **UN WOMEN ka paraqitur komentin:**

Projektligji duhet vlerësuar në referim të:

- Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020 - 2025: bën thirrje për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikat e BE-së, duke përfshirë bujqësinë dhe zhvillimin rural. Mbledhja dhe analiza e të dhënave të ndara sipas seksit është thelbësore për një planifikim të drejtë dhe gjithëpërfshirës;
- Programi Botëror për Regjistrimin e Bujqësisë 2020 (WCA 2020) i cili rekomandon mbledhjen e të dhënave mbi gjininë e pronarëve të fermave, ndarjen gjinore të punës, orët e punës, aksesin në inpute dhe rolet vendimmarrëse;
- Rregullorja (BE) 2018/1091 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 18 korrik 2018, mbi statistikën e integruar të bujqësisë dhe shfuqizimin e Rregulloreve (KE) nr. 1166/2008 dhe (BE) nr. 1337/2011, e cila kërkon mbledhjen e të dhënave mbi gjininë e menaxherëve të fermave, ndarjen gjinore të punës, performancën në punë, aksesin në inpute dhe rolet vendimmarrëse; gjithashtu lejon kryqëzimin e tabelave të gjinisë me variabla të tjerë si: mosha, struktura e pronësisë, madhësia e fermës dhe marrja e masave mjedisore;
- Instrumenti për Ndihmë Para-Anëtarësimi (IPA III) që kërkon integrimin horizontal të barazisë gjinore në të gjitha ndërhyrjet, përfshirë zhvillimin rural, dhe mbështet mbledhjen e të dhënave gjinore për politika të ndjeshme ndaj gjinisë;

- Statistikat gjinore të zhvilluara nga EIGE, të cilat përfshijnë gjithashtu të dhëna gjinore në fushën e bujqësisë për qëllime hartimi politikash dhe monitorimi.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti i mësipërm pranohet pjesërisht me arsyetimin se në projektligj janë reflektuar disa nga sugjerimet e UN Women në lidhje me barazinë gjinore.

Përmbajtja e pyetësorit të Censit të Bujqësisë do t'i nënshtrohet një faze tjetër konsultimi. Pyetësi i censit (si dokument) është përgjegjësi e INSTAT-it dhe nuk mund të jetë pjesë integrale e projektligjit. Projektligji është përafrim i pjesshëm i Rregullores (BE) 2018/1091.

2. UN WOMEN ka paraqitur komentin:

Projektligji nuk i referohet mbledhjes së të dhënave gjinore ose të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Rekomandim:

Ndryshohet neni 2 - "Objektivat e projektligjit për të përfshirë një referencë për të dhënat që lidhen me gjininë".

MBZHR shpreh qëndrimin se ky sugjerim pranohet dhe shkronja b), e nenit 2, riformulohet:

"b) Të ofrojë të dhëna të besueshme statistikore, përfshirë ato gjinore në fushën e bujqësisë, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit bujqësor në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimet statistikore të përcaktuara në legjislacionin për statistikat zyrtare".

3. UN WOMEN ka paraqitur komentin:

Përveç mbulimit që është cituar më poshtë (98%) në linjë me Rregulloren përkatëse, a ka detaje lidhur me thresholds?

Aneks 2 i Rregullores, citon: "List of the physical thresholds", të cilat nuk vihen re në këtë ligj. Thresholds duhet të specifikohen për rastin e Shqipërisë.

Rekomandim: Ndryshime në nenin 3 të projektligjit.

MBZHR shpreh qëndrimin se është dakordësuar në INSTAT të mos vendosen thresholds për shkak të kushteve specifike që ka Shqipëria. Është marrë një opinion paraprak edhe nga ekspertët e EUROSTAT-it për këtë. Specifikat teknike do të përcaktohen në pyetësorët e censit dhe metodologjitë përkatëse që janë përgjegjësi e INSTAT-it.

4. UN WOMEN ka paraqitur komentin:

"Drejtues (menaxher) i njësisë ekonomike bujqësore" është personi që merr vendimet ditore lidhur me planifikimin, organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve bujqësore apo blektorale në një njësi ekonomike bujqësore. Ky person mund të jetë i ndryshëm nga drejtuesi/pronari dhe mund të jetë një anëtar i familjes, një partner ose një i punësuar. Nëse njësi bujqësore është një person juridik (drejtuesi është zakonisht një person i caktuar që vepron në emër të entitetit juridik).

Koncepti i 3-të nuk bëhet i detyrueshëm nga Rregullorja e BE-së por sugjerohet nga FAO me qëllim grumbullimin më të mirë të treguesve gjinorë. FAO nëpërmjet WCA (shih <https://openknowledge.fao.org/server/api/core/bitstreams/c5afd226-08ab-4cda-bc45-871f1f95a3be/content>) këshillon/sugjeron edhe një definicion tjetër, atë të nëndrejtuesit: "Nëndrejtuesi është personi që menaxhon një aktivitet specifik (si një parcelë, njësi blektorale, etj.) brenda njësisë ekonomike bujqësore. Për ligjin e censit në Shqipëri është i rëndësishëm të dallohen nëndrejtuesit me qëllim për të matur përfshirjen e grave dhe burrave në bujqësi për aktivitete të dallueshme qartë.

Rekomandim: Ndryshime në nenin 4, lidhur me përkufizimin e “Drejtues i njësisë ekonomike bujqësore” dhe shtimin e përkufizimit “nëndrejtuesi”;

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet me arsyetimin pasi përkufizimi që kemi dhënë është në përputhje me strukturën e ndërtimit të subjekteve tregtare sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare. Paragrafi është dakordësuar në komunikim me ekspertët.

5. UN WOMEN ka paraqitur komentin:

Me përmbajtje: 17. “Treguesit gjinorë në Censin e Njësive Ekonomike Bujqësore” janë statistika të ndjeshme ndaj gjinisë që synojnë të masin dhe analizojnë dallimet mes grave dhe burrave brenda strukturës dhe funksionimit të njësive ekonomike bujqësore (NJEB).

Rekomandim: Të shtohet pika 17, në nenin 4 “Treguesit gjinorë në Censin e Njësive Ekonomike Bujqësore”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet dhe do të reflektohet në draftligj.

6. UN WOMEN ka paraqitur komentin:

- Opsion 1: I gjithë drafti të rishikohet me qëllim që gjuha të shëndrrohet në neutrale ose të përdoren të dy gjinitë kur është rasti.
- Opsion 2: Mund të shtohet një nen më vete i cili të ketë një referencë tek përdorimi i gjuhës në ligj, sipas sugjerimit me poshtë: “Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore. Shprehjet e përdorura në këtë ligj për personat në gjininë mashkullore nënkuptojnë të njëjtat shprehje edhe në gjininë femërore”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti i sugjeruar si opsioni 2 shtohet si nen i ri me këtë përmbajtje “Shprehjet e përdorura në këtë ligj për personat në gjininë mashkullore nënkuptojnë të njëjtat shprehje edhe në gjininë femërore”.

7. UN WOMEN ka paraqitur komentin:

Neni 6 “Të dhënat e mbledhura” liston gjininë mes karakteristikave të anëtarëve të njësive bujqësore që do të mbledhen, por lë jashtë mbledhjen e të dhënave të tjera sipas gjinisë. Gjithashtu, mungon mbledhja e të dhënave të klasifikuara sipas gjinisë për të përmirësuar analizën gjinore në sektorin bujqësor. Përdorimi i të dhënave të ndara sipas seksit, duke përfshirë treguesit e bazuar në gjini, është një komponent thelbësor për hartimin e politikave të ndjeshme ndaj gjinisë të bazuara në prova në bujqësi dhe zhvillim rural.

Programi Botëror i FAO-s për Regjistrimin e Bujqësisë 2030 ka identifikuar një numër të dhënash të lidhura me gjininë, duke pranuar se roli i gjinisë mund të kapet në një regjistër në temën *tokë*, për secilën parcelë, dhe në një regjistër tjetër në temën *blegtori*, për secilën specie blegtorale. Në përgjithësi, pikat e lidhura me gjininë, të cilat duhet të çojnë në politika dhe programe më të synuara sipas këtij programi, përfshijnë:

- gjinia në bujqësi;
- madhësia e familjes sipas gjinisë dhe grupmoshave;
- gjinia e menaxherit përveç mbajtësit të pronësisë;
- gjinia e anëtarit të familjes që menaxhon parcelën;
- numri i kafshëve sipas gjinisë së anëtarit të familjes që i menaxhon ato;
- puna në fermë për secilin anëtar të familjes në moshë pune (që përfshinte të dhëna mbi gjininë e anëtarit të familjes).

Programi Botëror i FAO-s për Regjistrimin e Bujqësisë 2030 sqaron se të dhënat mbi inputet e punës dhe karakteristikat e punësimit të mbledhura në *temën 9* për secilin anëtar

të familjes mund të përdoren për të studiuar përgjegjësitë e grave për punën në dhe jashtë fermës.

Ligji duhet të pasqyrojë një përputhje më të gjerë me Strategjinë e BE-së për Barazi Gjinore 2020 - 2025 dhe Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP), e cila i inkurajon Shtetet Anëtare të adresojnë boshllëqet gjinore në bujqësi përmes të dhënave, trajnimit dhe hartimit të politikave gjithëpërfshirëse. Rregullorja (BE) 2018/1091 mbi statistikën e integruara të fermave kërkon mbledhjen e të dhënave të detajuara strukturore, përfshirë "karakteristikat e menaxherit të fermës, duke përfshirë seksin dhe moshën". Përveç kësaj, rregulloret kërkojnë që të dhënat statistikore që lidhen me fermat bujqësore mundësojnë që të dhënat kryesore dhe të moduleve të kryqëzohen, duke lejuar kështu që informacioni të merret bazuar në variabla të tilla si gjinia e menaxherit të fermës bujqësore, moshë e menaxherit, struktura e pronësisë dhe madhësia e fermës bujqësore dhe marrja e masave mjedisore. Një ndarje e tillë e rezultateve do të jetë e mundur për kriteret e përfshira në të dhënat kryesore dhe për kombinimet e kriterëve. Mbledhja e informacionit mbi vitin e lindjes, vitin kur klasifikohet si menaxher i fermës bujqësore dhe gjininë mund të ofrojë të dhëna për zhvillimin e veprimeve në lidhje me ripërtëritjen e brezave dhe aspektet që lidhen me gjininë.

Rekomandim: Të ndryshohet neni 6.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet pjesërisht me arsyetimin se:

- Pika 1/a), iii nuk ndryshohet sepse:

1. Rregullorja (BE) 2008/1091 kërkon informacion mbi drejtuesin e fermës, menaxherin, pavarësisht pronar ose jo. Informacioni për nëndrejtes është i panjohur për INSTAT në një njësi ekonomike familjare, ndërsa tek ndërmarrjet bujqësore të cilat janë objekt i censit të bujqësisë, INSTAT përdor emërtimet pronar, bashkëpronar apo menaxher të ndërmarrjes. Për më tepër, INSTAT nuk bën raporte dhe analiza, por prodhon statistika që përdoren për analiza. Për këtë arsye mendojmë që paragrafi të mos ndryshohet.

2. Censi i bujqësisë siguron informacion, duke ju përmbajtur metodologjisë së paracaktuar dhe rregulloreve përkatëse të EUROSTAT-it.

Pika 1/a), iv nuk pranohet të shtohet sepse objekt i regjistrimit janë të gjithë NJEB, fizike apo juridike që kanë aktivitet bujqësor dhe blegtoral, nuk është e nevojshme të shtohet kjo pikë.

- Pika 1/b) pranohet pjesërisht sepse:

1. Informacioni merret për të gjithë NJEB që punojnë tokën, apo kanë aktivitet blegtoral, pavarësisht tokë në pronësi e marrë me qira apo në përdorim.

2. Nuk kërkohen prova shkresore në intervistë.

3. Pranohet shtesa “dhe/ose në përdorim”.

- Pika 1/c) nuk pranohet sepse:

Shtesa merret si informacion tek të dhënat e përgjithshme (neni 6/a e projektligjit).

- Pika 1/c):

I referohet vetëm informacionit që merret për aktivitetin blegtoral të njësisë ekonomike bujqësore.

- Pika 1/d) nuk pranohet sepse:

Informacioni mbi aktivitetet që kryhen në fermë merret për të gjithë fermën, por jo të ndara aktivitetet sipas anëtarëve të familjes. Karakteristikat e punësimit që janë përfshirë në pyetësor kanë lidhje me orët e punës si dhe periodicitetin e punës. Për personat e punësuar jo anëtarë të familjes merret informacion për angazhimin në punët kryesore apo sekondare të fermës, informacion ky i ndarë sipas gjinisë, moshës dhe orëve të punës. Nisur nga metodologjia si dhe specifikat e njësive ekonomike bujqësore në vendin tonë është e pamundur të merret si informacion.

- Pika 4 nuk shtohet sepse:

Ky paragraf përcaktohet në nenin 14 të projektligjit për shpërndarjen e rezultateve. Neni 6 është vetëm për natyrën e mbledhjes së të dhënave.

8. **UN WOMEN ka paraqitur komentin:** Germa “c” e nenit 14 përsërit pikën e mësipërme.

Rekomandimi: të ndryshohet neni 14, germa “c”.

MBZHR shpreh qëndrimin komenti nuk pranohet me arsyetimin pasi sqarojmë se germa “b” e nenit 14 të projektligjit ka lidhje me nivelin e të dhënave. Germa “c” ka lidhje me formën e publikimit.

9. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** “Propozohet shtesa e një shkronje me këtë përmbajtje:

c) INSTAT-i përgatit dhe publikon raporte analitike që theksojnë dimensionin gjinor të të dhënave të censit”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet pjesërisht me arsyetimin “Ky nen i dedikohet vetëm rezultateve të censit të bujqësisë. INSTAT nuk është i detyruar me ligj të kryejë analiza të të dhënave. Megjithatë, për të reflektuar sugjerimin mbi statistikat gjinore, pranohet shtesa e germës “c” me këtë përmbajtje:

c) Në rezultatet e censit të bujqësisë përfshihen edhe të dhënat statistikore gjinore në fushën e bujqësisë”.

9. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** të shtohet në nenin 15, pika 1 me këtë përmbajtje: “1) Komisioni duhet të garantojë një përbërje të balancuar gjinore dhe kur është e mundur, përfshirjen e ekspertizës me njohuri të thelluara në barazi gjinore në lidhje me sektorin bujqësor”.

MBZHR shpreh qëndrimin, komenti nuk pranohet me arsyetimin se nuk përcaktohet dot raporti gjinor sepse përbërja e komisionit është nominativ sipas emrave të titullarëve përfaqësues.

10. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** shtesë në nenin 18, të germës “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) siguron trajnime periodike për çështjet e barazisë gjinore dhe mbi qasjen gjinore për personelin që harton censin e bujqësisë, regjistruarit dhe analistët e të dhënave”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet pjesërisht me arsyetimin se paragrafi i propozuar krijon konfuzion në perceptimin e objektit të projektligjit. Çështjet e barazisë gjinore janë shumë dimensionale dhe shkojnë përtej objektit të këtij ligji. Neni 24 e përcakton përbërjen e personelit të censit dhe emërtimet përkatëse. Për rrjedhojë, në këtë pikë nuk është e nevojshme të specifikohet çdo pozicion. Përsa më sipër, shkronja “ë” e propozuar riformulohet me këtë përmbajtje: “siguron trajnime për personelin e censit të bujqësisë mbi respektimin e parimeve të barazisë gjinore”.

11. **UN WOMEN ka paraqitur komentin:** Propozohet shtesa e pikës 3 me këtë përmbajtje:

3. INSTAT dhe Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë, gjatë hartimit të pyetësorëve dhe planifikimit të censit, organizojnë konsultime për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e censit”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet pjesërisht me arsyetimin se roli i KQC është vetëm mbështetës dhe nuk merr pjesë ekzekutive në fazat e hartimit të pyetësorit apo planifikimit të censit. Për arsye organizative apo cenimit të perceptimit mbi pavarësinë profesionale, KQC nuk mund të përfshihet në paragrafin e propozuar. Për këtë arsye, pika 3 e propozuar pranohet pjesërisht me këtë përmbajtje:

“3. INSTAT, gjatë hartimit të pyetësorit dhe planifikimit të censit, organizon konsultime për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e censit”.

12. **UN WOMEN ka paraqitur komentin:** Reformulim i pikës 4, të nenit 19 të projektligjit “4. Komisioni i Censit të Bujqësisë, në respektim të plotë të përfaqësimit gjinor, në nivel bashkie përbëhet nga këta anëtarë:

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet me arsyetimin se nuk përcaktohet dot sepse përberja e Komisionit është nominative.

13. **UN WOMEN ka paraqitur komentin:** “Të bëhet shtesa në nenin 20 “Detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të Censit...”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet sepse kjo pikë ka të bëjë me suportin logjistik, jo me përmbajtjen lëndore të manualeve informuese.

14. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** në nenin 20, në pikën 1/dh) propozohet shtesa: Raportimi duhet të përfshijë vlerësim mbi përfshirjen gjinore në të gjitha fazat e procesit të censit”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet dhe do të reflektohet shtesa e fjalisë në fund të pikës 1/dh), të nenit 20 të projektligjit me këtë përmbajtje:

“Raportimi duhet të përfshijë vlerësime mbi përfshirjen gjinore në të gjitha fazat e procesit të censit”.

15. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** “Në pikën 4, të nenit 21, shtohet fjalia “Kjo rregullore duhet të përfshijë dispozita për përfaqësimin e balancuar gjinor”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet referuar argumentimit më lart, balanca gjinore e Komisionit është e pamundur.

16. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** në fund të pikës 1, të nenit 23 propozohet shtesa e një fjalie me këtë përmbajtje: “Fushata duhet të synojë informimin e të gjitha grupeve shoqërore dhe të përmbajë gjuhë korrekte sic specifikohet në nenin 5 të këtij ligji”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet shtesa e fjalisë në fund të pikës 1, të nenit 23 të projektligjit me këtë përmbajtje: “Fushata duhet të synojë informimin e të gjitha grupeve shoqërore dhe të përmbajë gjuhë korrekte”.

17. **UN WOMEN ka paraqitur komentin:** “INSTAT-i merr masa për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor në rekrutimin dhe trajnimin e personelit të përfshirë në hartimin, realizimin e censit dhe përpunimin e të dhënave, në të gjitha nivelet”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti: Pranohet shtesa e pikës 7, në nenin 24 të projektligjit me këtë përmbajtje: “7. INSTAT-i merr masa për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor në proceset e rekrutimit dhe trajnimit të personelit të censit”.

18. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** “Riformulohet shkronja a), pika 1, e nenit 26 siç vijon: “Refuzimi për të dhënë informacionin e kërkuar ose dhënia e informacionit të rremë, sipas nenit 8 të këtij ligji, me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në zbatim të kësaj pike, duhet të marren parasysht rrethanat shtrënguese me prejardhje gjinore, përfshirë stigmatizimin ose normat sociale që mund të

kufizojnë pjesëmarrjen e grave ose të personave të tjerë në dhënien e informacionit. Këto rrethana duhet të vlerësohen përpara vendimmarrjes për vendosjen e masave administrative ndëshkuese”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet me arsyetimin se është tekst përshkrimor. Penalitetet dhe procedurat për ekzekutimin e tyre përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për gjokat dhe kundërvajtjet administrative.

19. **UN WOMEN ka paraqitur komentin** “Riformulohet pika 3, e nenit 27 të projektligjit. 3. INSTAT-i është përgjegjës për konstatimin e shkeljeve të detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit statistikor, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji dhe e referon rastin pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në rastet e shkeljes së të dhënave personale. Rastet që lidhen me ekspozimin e të dhënave të grave apo grupeve vulnerabël duhet të trajtohen me përparësi për të shmangur rrezikun e stigmatizimit apo diskriminimit”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet me arsyetimin se penalitetet dhe procedurat për ekzekutimin e tyre përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për gjokat dhe kundërvajtjet administrative.

20. **UN WOMEN ka paraqitur komentin:** Riformulohet neni 30 i projektligjit “Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it miraton brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rregulloren për funksionimin e Komisionit të Censit të Bujqësisë në nivel bashkie, sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji”. Rregullorja për funksionimin e komisioneve të censit duhet të përcaktojë gjithashtu masat për garantimin e barazisë gjinore në të gjitha fazat e zbatimit të censit”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet dhe do të reflektohet në draftligj.

21. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Riformulim i nenit 2 “Qëllimi i Censit të Bujqësisë”. Censi i Bujqësisë bëhet me qëllim që:

a) të sigurojë informacion të plotë, të përgjithshëm dhe të detajuar mbi strukturën, veprimtarinë dhe karakteristikat e të gjitha njësive ekonomike bujqësore në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) të prodhojë të dhëna statistikore të besueshme, të harmonizuara dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht, të nevojshme për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të zhvillimit bujqësor, rural, mjedisor dhe ekonomik, në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare dhe parimet e Sistemit Evropian të Statistikave;

c) të krijojë dhe përditësojë Regjistrin Statistikor të Njësive Ekonomike Bujqësore, si një bazë e integruar e të dhënave, e cila shërben për analizën e qëndrueshmërisë bujqësore, zhvillimin e politikave kombëtare dhe përafrimin me kërkesat e Bashkimit Evropian.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet pasi sugjerimet për ndryshime janë në të njëjtën frymë me përmbajtjen e këtij neni. Legjislacioni për statistikat zyrtare e detyron INSTAT-in të prodhojë statistika sipas standardeve të Sistemit Evropian, pasi këto parime janë të përafruara në ligj (nenet 4 dhe 5). Regjistri statistikor ka nevojë për formalizim dhe pastaj do të përditësohet me të dhëna administrative ose nga anketat. Për këte arsye, një nga qëllimet e censit është krijimi i tij nga ana formale. Qëllimi i regjistrit shkon përtej përshkrimit të propozuar në shkronjën b) të këtij neni (p.sh. kërkime shkencore, studime, analiza etj.). Për këtë arsye, sugjerimet nuk merren parasysh dhe i qëndrojnë origjinalit.

22. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Riformulim i pikës 2, të nenit 3 “2. Të dhënat e mbledhura sipas këtij censusi duhet të garantojnë një nivel përfaqësueshmërie që mbulon të paktën 98% të sipërfaqes së përdorur për qëllime bujqësore (përfshijë kopshtaria familjare) dhe 98% të njësive blegtorale ekzistuese në

territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e Rregullores (BE) 2018/1091 mbi statistikën e integruara të fermës”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet me arsyetimin se paragrafi është konsultuar dhe dakordësuar me ekspertët. Rregullorja 2018/1091 nuk mund të vendoset në tekst. Referenca e rregullores jepet në referencën e projektligjit.

23. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Riformulimi i pikës 3, të nenit 3 të projektligjit. 3. Pyjet dhe kullotat në pronësi publike nuk përfshihen në fushën e zbatimit të këtij censusi, përveç rasteve kur shfrytëzohen drejtpërdrejt nga njësitë ekonomike bujqësore për aktivitetin e tyre bujqësor ose blegtoral”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet dhe do të reflektohet në draftligj.

24. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Lidhur me pikën 10, të nenit 4 të projektligjit termi “kopshtari” zëvendësohet me “kopshtari familjare”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet, ndryshimet e propozuara janë të të njëjtës frymë. Për shkak të teknikës legjislative, projektakti nuk mund të përmbajë fjalë apo grup fjalësh në kllapa. Kur themi “metoda të tjera alternative” përfshihet çdo lloj metode tjetër përveç atyre të parashikuara në ligj. Pikat e vendosura nuk duhet të ndryshohen pasi i përmbahen rekomandimeve të FAO-s për Censin e Bujqësisë, kapitulli 4, pika 4.10.

25. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Shkronjat c) dhe ç) të pikës 1, të nenit 5, riformulohen:

c) të dhëna administrative të mbajtura nga institucionet publike dhe entet përgjegjëse, sipas pikës 2 të këtij neni;

ç) burime dhe metoda të tjera alternative, përfshirë integrimin e teknologjive digjitale, regjistrave elektronikë dhe të dhënave të mbledhura përmes sistemeve gjeohapësinore (GIS, remote sensing, etj.).

MBZHR shpreh qëndrimin komenti nuk pranohet sepse ndryshimet e propozuara janë të të njëjtës frymë. Për shkak të teknikës legjislative, projektakti nuk mund të përmbajë fjalë apo grup fjalësh në kllapa. Kur themi “metoda të tjera alternative” përfshihet çdo lloj metode tjetër përveç atyre të parashikuara në ligj. Pikat e vendosura nuk duhet të ndryshohen pasi i përmbahen rekomandimeve të FAO-s për censin e bujqësisë kapitulli 4, pika 4.10.

26. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Në pikën 2, të nenit 5 shtohet fjalia: si dhe me standardet e Sistemit Evropian të Statistikave (ESS)”.

MBZHR shpreh qëndrimin komenti nuk pranohet, legjislacioni për statistikën zyrtare detyron prodhuesin e statistikave zyrtare të zbatojë standardet e Sistemit Statistikor Evropian.

27. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “lidhur me termin në pikën 3, neni 5 termi: “punët e brendshme” është i paqartë. Të fshihen fjalët: “duke krijuar mekanizmat dhe infrastrukturën e nevojshme të bashkëpunimit për furnizimin dhe transmetimin e të dhënave”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet, riformulohet pika 3: “Institucionet publike përgjegjëse për bujqësinë, turizmin dhe mjedisin, punët e brendshme, pushtetin vendor dhe Agjencia Kombëtare e Kadastrës, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, vënë në dispozicion të INSTAT-it të dhëna administrative për lehtësimin e veprimtarive të censit, sipas kërkesës së këtij organi”.

28. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** në pikën 3, të nenit 6 të projektligjit. Pas fjalës ... regjistri tjetër administrativ shtohet fjala ose fiskal.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranoet sepse në gjykimin tonë edhe një regjister i natyrës fiskale hyn në kategorinë e regjistrit administrativ.

29. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Lidhur me nenin 10 të projektligjit ka nevojë të detajohet dhe të përkufizohet “Dita e Censit”, çfarë përfaqëson? Kështu do të dalë e qartë nëse ajo caktohet apo përcaktohet, sikurse shkruhet këtu”.

MBZHR shpreh qëndrimin qëndrimin se komenti nuk pranohet përkufizimi i “Ditës së Censit” është dhënë në pikën 8, të nenit 4 “Përkufizime”.

30. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** lidhur me pikën 3, të nenit 12 të projektligjit. Lidhur me termin e “acquis e BE-së”. Mund të thuhet legjislacioni i BE-së, për të qenë më shqip. Acqui dhe legjislacioni i BE-së janë sinonime.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet dhe ndryshimi do të reflektohet në projektligj.

31. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Termi në pikën 3, të nenit 13 të projektligjit”. “3. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni është i dënueshëm edhe kur personi ka ndërprerë përfshirjen në cens. Ky term është i papërcaktuar. Duhet theksuar se si ndëshkohet ky person për këtë shkelje”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet dhe do të saktësohet referenca për shkeljen e konfidencialitetit në nenin 26 të projektligjit.

32. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Lidhur me nenin 15 përbërja e Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë, ministrat përgjegjës do ta kryejnë vetë këtë detyrë? Nëse jo, atëherë duhet të ketë dispozitë që ata duhet të delegojnë me autorizim”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet sepse çdo Komision Censi ka patur këtë përbërje në nivel të lartë përfaqësimi.

33. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Lidhur me nenin 16 shkronja b). Termi “dhe shoqëria civile; ky është një term shumë i përgjithshëm. Mendojmë se duhet të detajohet, përndryshe mund të ketë pasoja në zbatimin e ligjit dhe të krijojë konfuzion ose klientelizma”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet sepse bëhet fjalë për mbështetje për të marrë informacion nga shoqëria civile. Rasti është i aplikueshem tek organizata që kanë për natyrë veprimtarie fushën e bujqësisë.

33. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “shkronja ç), e nenit 16, riformulohet ç) miraton projekt-kalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë, i cili përgatitet nga INSTAT-i, duke siguruar përputhshmëri me standardet e EUROSTAT dhe organizatave ndërkombëtare për statistikat e bujqësisë”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti nuk pranohet shtesa për arsyet e lartpërmendura.

34. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentin** “Lidhur me shkronjën d), të nenit 16: d) Shqyrton çdo kërkesë të paraqitur dhe lëshon autorizim të veçantë në lidhje me miratimin për mbledhjen e informacionit nga publiku gjatë periudhës prej 4 javësh, përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave të censit, në përputhje me nenin 25 të këtij ligji”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komenti pranohet modifikohet paragrafi: “shqyrton çdo kërkesë të paraqitur nga individët apo organizatat sipas nenit 25 të këtij ligji dhe lëshon autorizim në lidhje me miratimin për mbledhjen e informacionit nga publiku gjatë

periudhës prej 4 javësh, përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave të censit”.

34. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare** ka paraqitur komentën shtohet shkronja dh), në nenin 16 të projektligjit. dh) Monitoron respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave dhe siguron që përdorimi i tyre të bëhet vetëm për qëllime statistikore.

MBZHR shpreh qëndrimin se komentë nuk pranohet KQC ka vetëm funksion mbështetës dhe nuk mund të ndërhyjë në proceset statistikore apo ti monitorojë ato pasi cenohet parimi i pavaresisë profesionale. Respektimi i parimit të mbrojtjes së të dhënave është detyrim ligjor i INSTAT-it dhe Komisionerit.

34. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur koment** lidhur me termin e përdorur në nenin 19, pika 2. Lidhur me termin “Instruksionet” - “Kanë vlerë juridike instruksionet? A janë akte të tjera përpos udhëzimeve?

MBZHR shpreh qëndrimin se komentë nuk pranohet, në komision merr pjesë një përfaqësues nga INSTAT-i cili mund të japë instruksione orientuese për censin.

35. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare** ka paraqitur koment “2. Fushata informuese fillon të paktën 4 javë para ditës së censit të bujqësisë dhe përfundon me nxjerrjen e rezultateve përfundimtare të tij. Mendojmë se ka nevojë për një detajim të procedurave bazë për kryerjen e fushatës dhe të institucioneve përgjegjëse për të. Këtu mund të përfshihen edhe Universiteti Bujqësor dhe organizata të fushës”.

MBZHR shpreh qëndrimin se komentë pranohet fushata informuese është përgjegjësi e INSTAT-it, është gjithëpërfshirëse dhe mjaft komplekse. Ajo zbatohet sipas një strategjie e cila përgatitet me suportin e ekspertëve të huaj. Për të përmbushur sugjerimin, shtohet paragrafi 2, me këtë përmbajtje: “Strategjia për kryerjen e fushatës informuese përgatitet nga INSTAT-i jo më vonë se 4 muaj para ditës së censit të bujqësisë”.

35. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur komentën **të shtohet një nen lidhur me financimin. Neni “Financimi”**.

1. **Financimi i censit të bujqësisë** sigurohet nga buxheti i shtetit, përmes fondeve të veçanta të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të **INSTAT-it**.
2. Përveç buxhetit të shtetit, censusi i bujqësisë mund të mbështetet edhe nga:
 - a) **fondet e Bashkimit Evropian**, përfshirë Instrumentin e Para-Anëtarësimit (IPA) dhe programet e tjera të ndihmës financiare;
 - b) **kontributet e donatorëve ndërkombëtarë** dhe organizatave partnere në fushën e zhvillimit rural dhe statistikave;
 - c) **burime të tjera financiare**, të ligjshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. **INSTAT**, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, zhvillimin rural, mjedisin, financat, pushtetin vendor, si dhe me **Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit**, është përgjegjës për sigurimin e burimeve njerëzore.

MBZHR shpreh qëndrimin se është dakord me shtesën e një neni të veçantë për financimin. Me përjashtim të pikës 3 të nenit, e cila nuk pranohet pasi nuk ka lidhje me financimin teknike dhe logjistike të nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e censit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji siç vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) INSTAT-i;
- c) Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë dhe;
- ç) Komisionet e Censit të Bujqësisë në nivel bashkie.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e mbledhjes së informacionit statistikor në bujqësi. Si autoriteti kompetent qendror MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore në varësi të saj përmes së cilave ajo informohet në kohë reale për monitorimin në terren dhe zbatimin e ligjit. Agjencia Rajonale të Ekstensionit Bujqësor përkatësisht do të monitorojë dhe raportojë nga terreni si autoriteti përgjegjës. Në kuadër të arritjes së objektivave të institucionit në MBZHR është ngritur dhe funksionon njësi përgjegjëse për statistikave: Drejtoria e Statistikave, Analizës dhe Raportimeve. DSAR kryen këto funksione:

1. Prodhon informacion të saktë dhe koherent për të mbështetur analizat efektive dhe vendimet e politikëbërjes nga MBZHR.
2. Mbledh dhe përpunon të dhëna në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë të cilat i transmetohen INSTAT-it për prodhim dhe publikim në faqen zyrtare.
3. Grumbullon dhe përpunon informacion statistikor të ardhur nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për indikatorët në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agroindustrisë.
4. Kryen vrojtime të ndryshme për grumbullimin e informacionit, përpunimin e të dhënave në lidhje me treguesit statistikor bujqësor për t'iu përgjigjur kërkesave gjithmonë në rritje nga përdoruesit, në bashkëpunim me INSTAT, me fokus edhe përditësimin e Regjistrit të Fermës.
5. MBZHR merr të gjitha masat për ngritjen e Rrjetit të Kontabilitetit të Fermës (FADN), duke krijuar edhe një sektor të posaçëm, konkretisht FADN në Drejtorinë e Statistikave, Analizës dhe Raportimeve.

- **Instituti i Statistikave (INSTAT) ka këto përgjegjësi:**

- a) përcakton ditën e censit, harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësorin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen e zbatimit të censit në baza profesionale dhe shkencore;
- b) menaxhon burimet njerëzore dhe financiare përkatëse dhe informon Komisionin Qendror të Censit të Bujqësisë dhe donatorët ndërkombëtarë mbi përdorimin e këtyre burimeve;
- c) udhëzon komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie, të ngritura sipas parashikimeve të nenit 19 të këtij ligji, për detyrat që kanë për mbështetjen e censit;

ç) u propozon autoriteteve publike përkatëse hapat që duhen ndërmarrë për censin e bujqësisë;

d) zhvillon fushatën për informimin e publikut;

dh) kryen procedurat e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe trajnimit të stafit të terrenit me mbështetjen, sipas nevojës, komisioneve të censit të bujqësisë në nivel bashkie;

e) drejton punën për realizimin e censit të bujqësisë në të gjitha fazat, në bashkëpunim me institucionet dhe organet mbështetëse të censit të bujqësisë;

ë) përpunon të dhënat e mbledhura nga censi i bujqësisë dhe ndërmerr masat e duhura për mbrojtjen e konfidencialitetit të tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 13 të këtij ligji;

f) paraqet e boton rezultatet përfundimtare të censit në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;

g) i raporton Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë ecurinë e aktiviteteve të censit;

gj) kryen detyrën e sekretariatit të Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë dhe ka këto detyra:

i. njofton anëtarët e Komisionit për mbledhjen e radhës;

ii. mban procesverbalin e mbledhjes;

iii. përgatit dokumentacionin bazë të mbledhjes, të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes.

2. Për kryerjen e suksesshme të censit të bujqësisë dhe për të garantuar zbatimin e parimeve statistikore sipas legjislacionit për statistikat zyrtare, INSTAT-i ka të drejtë të ndërmarrë çdo aktivitet tjetër të paparashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Monitorimi i zbatimit të ligjit sipas kompetencave e ka INSTAT, i cili gjatë përmbushjes së detyrave të tij edhe monitoron procesin. INSTAT është përgjegjës edhe për shqyrtimin, verifikimin, marrjen e vendimeve dhe ankimin për kundërvajtjet administrative të konstatuara, në respektim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjit për kundërvajtjet administrative. Projektligji në parashikimin e tij për personelin e INSTAT ka caktuar punësimin e mbikëqyrësve, të cilët menaxhojnë, mbështesin dhe raportojnë punën e kontrollorëve të varësisë.

- **Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë** ka këto përgjegjësi:

a) harton dhe miraton rregulloren e Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë;

b) ndjek përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë dhe mbështet INSTAT-in për të siguruar furnizimin me të dhëna nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile;

c) lehtëson bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve publike e shkencore për mbështetjen e censit;

ç) miraton projektalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë, i cili përgatitet nga INSTAT-i;

d) shqyrton çdo kërkesë të paraqitur dhe lëshon autorizim të veçantë në lidhje me miratimin për mbledhjen e informacionit nga publiku gjatë periudhës prej 4 javësh, përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave të censit, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

Monitorimi i zbatimit të ligjit sipas kompetencave të sipërcituara e ka vet Komisioni, i cili në përshkrimin e detyrave të tij ka edhe monitorimin e procesit.

- **Komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie** kanë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

a) mbështesin INSTAT-in në organizimin e punës të censit të bujqësisë në zonat e numërimit, brenda juridiksionit përkatës të bashkisë;

- b) ndihmojnë INSTAT-in në përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve që do të përdoren gjatë fushatës së informimit;
 - c) ndihmojnë INSTAT-in gjatë procesit të rekrutimit për punonjës terreni;
 - ç) i sigurojnë dhe vënë në dispozicion të personelit të censit ambiente të nevojshme për të mbështetur proceset e censit sipas kërkesave të INSTAT-it dhe/ose Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë;
 - d) mbështesin INSTAT-in për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë procesit të censit të bujqësisë;
 - dh) i raportojnë periodikisht INSTAT-it, dhe sipas kërkesës së këtij të fundit, për ecurinë e përmbushjes së detyrave të parashikuara në këtë nen.
- Monitorimin e zbatimit të ligjit sipas kompetencave të sipërcituara e kanë komisionet të cilët gjatë përshkrimit të detyrave të tyre kanë edhe monitorimin e procesit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Bujqësia mbulon 47% të territorit të BE-së dhe ndikimi mjedisor i praktikave bujqësore, por edhe shërbimet mjedisore të ofruara nga bujqësia janë të mëdha. Bujqësia përdor tokën, ujin, ajrin dhe biodiversitetin dhe ndikon në këto burime nëpërmjet praktikave të menaxhimit të tokës dhe modeleve të inputit, prodhimit, të korrave dhe blegtorisë. Bujqësia luan gjithashtu një rol të veçantë në funksion të ndryshimeve klimatike por gjithashtu mund të mbrojë rezervat e karbonit që lidhen me tokën bujqësore nëpërmjet praktikave të mira të menaxhimit. Pa njohuri të plotë se çfarë prodhohet ku dhe nga kush përmes statistikave të cilësisë së lartë, do të ishte shumë e vështirë të hartohen politikat e duhura bujqësore, mjedisore dhe të tjera që lidhen me to.

Bujqësia prodhon afërsisht 100% të ushqimit që konsumojmë dhe siguria ushqimore është e panegociueshme. Njohuritë e hollësishme të strukturave të prodhimit dhe zinxhirëve të furnizimit janë thelbësore për të pasur reagime të shpejta përmes masave adequate, veçanërisht në raste të menaxhimit të krizave. Në kontekstin global, çmimet gjithnjë e më të paqëndrueshme të ushqimeve së bashku me një popullsi botërore ende në rritje paraqesin sfidë për të gjitha vendet. Të dhënat mbi çmimet, rendimentet dhe strukturat e prodhimit përdoren në analizat e tregut dhe modellet e perspektivës së tregut për zhvillimin dhe menaxhimin e politikave. Ato përdoren gjithashtu gjerësisht nga operatorët privatë për të reduktuar asimetritë në informacionin e tregut.

Sigurimi i statistikave cilësore në mbështetje të politikave evropiane është një objektiv kryesor për statistikave evropiane në kuadër të programit të tregut të vetëm.

Shqipëria, në ndjekje të modelit evropian harton politika të cilat do të mbështeten në informacione statistikore cilësore, të krahasueshme dhe të besueshme mbi situatën ekonomike, sociale, territoriale dhe mjedisore të cilat sot zbatohen në të gjithë vendet

anëtare të BE-së. Statistikat bujqësore ofrojnë cilësi të lartë të nevojshme për zbatimin dhe monitorimin e PPB².

Zbatimi i PPB-ve nga vendet anëtare të BE-së por edhe vendet aspirante siç është vendi ynë, është i rëndësishëm duke patur parasysh funksionin shtytës që kanë për hapjen e vendeve të reja të punës, rritjen e ekonomisë në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në komunitetin evropian. Politikat e zhvillimit rural si pjesë integrale e PPB-së synojnë të përmirësojnë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e prodhimit bujqësor krahas objektivave të saj sociale. Statistikat bujqësore nevojiten gjithnjë e më shumë për politika të tjera kyçe të BE-së, si Marrëveshja e Gjellbër Evropiane³, politikat mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike, si dhe politikat tregtare, sociale dhe rajonale.

Në Shqipëri në vitin 1924 për herë të parë u krijua një zyrë statistikore që mbante evidenca të ndryshme ekonomike pranë Ministrisë së Botorës (mirëmbajtjes së rrugëve) dhe Bujqësisë⁴. Veprimtaria e kësaj zyre kufizohej në inventarët bujqësorë që përfshinin numrin e bujqëve dhe llojin dhe sasinë e shfrytëzimit të tokës me bimë bujqësore e blegtorale, si dhe në disa statistika të cekta mbi industrinë, tregtinë, eksport-importet dhe çmimet.

Për herë të parë shërbimi statistikor në Shqipëri është institucionalizuar me Dekretin nr. 121, datë 8.4.1940. Sistemi statistikor në shtetin shqiptar është themeluar me Vendimin nr. 35, datë 13.1.1945 me krijimin e Drejtorisë së Statistikës të atashuar pranë Këshillit të Ministrave. Më vonë kjo drejtori kaloi nën varësinë e Komisionit të Planit të Shtetit.

Sot, në zbatim të Ligjit nr. 17, datë 5.4.2018 “Për statistikat zyrtare”, ky sistem përbëhet nga një numër institucioneve të ngarkuar për prodhimin e statistikave zyrtare dhe institucione të tjera, publike ose jo, të cilët nxjerrin statistika të fushave të ndryshme për monitorimin apo zbatimin e politikave të veta zhvilluese. Sistemi Kombëtar Statistikor e ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin e lartpërmendur dhe Programin Shumëvjeçar të Statistikave, i cili miratohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Shqipërisë. Përgjegjës për zbatimin e Programit dhe monitorimin e Sistemit Statistikor është Instituti i Statistikave (INSTAT) si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare⁵.

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Roli i INSTAT-it është të marrë të dhënat, t'i përpunojë ato dhe të përpilojë agregate, të vërtetojë dhe sigurojë cilësinë (monitorimi, analizimi, hetimi dhe përmirësimi i cilësisë së të dhënave) të publikojë informacionin në faqen e tij të internetit.

Instituti i Statistikave zë gjithashtu një rol kyç në procesin integruar për shkak të përballjes së kërkesave gjithnjë e më rritje për indikatorë statistikorë në fusha të ndryshme. Për rrjedhojë, INSTAT është pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian në pjesën më të madhe të kapitujve të *acquis communautaire*, ndërkohë që është

² Politikat e Përbashkëta Bujqësore (CAP) është partneriteti midis shoqërisë dhe bujqësisë përmes së cilit synohet të sigurohet furnizim i qëndrueshëm me ushqimi, mbrojtje të të ardhurave të fermerëve, mbrojtje të mjedisit dhe të zonave rurale.

³ Në nëntor 2020, Shqipëria nënshkroi Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, duke u përballur në këtë mënyrë me detyrimet e Strategjisë së Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane drejt një ekonomie moderne, neutrale ndaj klimës, burimeve efikase dhe konkurruese.

⁴ Historik nga INSTAT <https://www.instat.gov.al/sq/rreth-nesh/>

⁵ Burimi: <https://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/>.

përgjegjës koordinator për Kapitullin 18 “Statistikat”. Në këtë aspekt, roli i INSTAT bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për vazhën e çeljes së negociatave për anëtarësim në BE⁶.

Programi i Statistikave Zyrtare 2022 - 2026, miratuar me Ligjin nr. 30/2022, në nëndarjen “*Bujqësia, pyjet dhe peshkimi*” ka përfshirë në analizë qëllimin e nëntemës së statistikave të produkteve bimore lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave të prodhimit bimor, metodat e prodhimit bimor dhe prodhimet organike. Statistikat e prodhimit bimor japin informacion për drithërat, bimët industriale, rrënjoret, fasulet, perimet, të tjera bimë të arave, frutat, agrumet, ullirin dhe vreshtat. Të dhënat për kulturat e para dhe të dyta mbledhen, përpunohen dhe vlerësohen si në fushë të hapur ashtu dhe në serra. Për prodhimin e statistikave të prodhimit bimor përdoren burime të kombinuara administrative dhe vërtetime të drejtpërdrejta në terren me anketues, si dhe metoda të kombinuara llogaritjeje, të drejtpërdrejta dhe me vlerësim. Statistikat e bimëve përfshijnë statistikat e bimëve të arave (grurë, misër, elb, thekër, tërshërë), sipërfaqe, prodhim dhe rendiment.

- Statistikat e bimëve të tjera të arave: patate, fasule, bimë industriale (luledielli, sojë dhe duhan), si dhe bimët foragjere (misër foragjer, jonxhë dhe të tjera foragjere që kositen të gjelbra).
- Statistikat e perimeve: perime në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe dytë.
- Statistikat e drufrutorëve: pemët frutore, agrumet, ullinjtë, rrushi dhe fidanishtet e drufrutorëve.

Të dhënat janë vjetore, sipërfaqja shprehet në ha, rendimenti në kv/ha, prodhimi në ton dhe lagështia në %. Për pemëtoret në blloqe, të dhënat janë në ha dhe në numër rrënjësh, ndërsa për pemët e shpërndara, e dhëna është vetëm në numër rrënjësh.

- Nëntema e statistikave të blegtorisë, mishit dhe vezëve ka si qëllim të sigurojë të dhëna të harmonizuara rajonale dhe kombëtare lidhur me strukturën e blegtorisë, prodhimin e mishit dhe të vezëve me ato të BE-së. INSTAT-i mbledh, përpunon dhe publikon statistikat e blegtorisë, mishit dhe vezëve duke shfrytëzuar burimet administrative, si dhe vërtimet statistikore pranë njësive ekonomike blegtorale dhe ndërmarrjeve ekonomike bujqësore. Për prodhimin e statistikave të kësaj natyre, INSTAT-i mbledh të dhëna në lidhje me therjet e shpendëve dhe prodhimin e vezëve në fermë nëpërmjet vërtimit vjetor në bujqësi, si dhe të dhëna lidhur me tregtinë e jashtme të shpendëve.
- Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij përfshijnë statistikat në nivel rajonal dhe kombëtar në lidhje me prodhimin e qumështit dhe produkteve të qumështit nga lopët, delet dhe dhitë.
- Të dhënat grumbullohen me frekuencë mujore dhe vjetore në ndërmarrjet e përpunimit të qumështit dhe baxhot, të cilat blejnë qumësht të papërpunuar direkt nga fermat ose pikat e grumbullimit, sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave. Vërtimi i strukturës së fermës (Censi i Bujqësisë) dhe vërtimet e ndërmjetme me kampion janë shtylla të sistemit statistikor bujqësor. Bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet vërtimit të strukturës së fermave sintetizohen tregues me anën e të cilëve përcaktohet tipologjia e fermave bujqësore në të gjitha degët e saj, si dhe madhësia ekonomike e tyre. Struktura e fermave bujqësore përfshin të gjitha llojet e organizimit të fermave bujqësore, blegtorale, mikse apo çdo lloj tjetër organizimi që plotëson definicionin për të qenë njësi ekonomike bujqësore. Fushat e aktiviteteve të mbuluara në këtë temë janë regjistrimet e bujqësisë dhe vërtimet e strukturës së fermave, 2–3 vërtime në periudhën 10-vjeçare

⁶ Strategjia e Zhvillimit të INSTAT 2017-2030, fq.12 https://www.instat.gov.al/media/3987/projekt-strategjia-per-instat_31-08-2017.pdf

midis dy censesve. Objekt vrojtimi për strukturën e bujqësisë do të jenë të gjitha njësitet ekonomike bujqësore që kryejnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Statistikat mbi prodhimin bujqësor, duke përfshirë të dhënat e bujqësisë organike, kanë për objekt ato ferma që japin një kontribut të rëndësishëm në prodhimin total, i cili mund të jetë shumë i ndryshëm nga shteti në shtet. Përdorimi i burimeve administrative promovuar dhe zhvilluar në nivele optimale në këtë fushë, kështu modelet dhe parashikimet janë pjesë e këtij procesit statistikor.
- Përdoruesit e të dhënave statistikore zyrtare përfshijnë disa grupe të cilat ndahen nga natyra e interesit që kanë në fushën e bujqësisë. Kemi identifikuar disa grupe siç vijon:
 1. Përdorues me interes të përgjithshëm: gazetarë, media dhe qytetarë;
 2. Përdoruesit me një interes specifik si p.sh. vendimmarrës/politikëbërës rajonalë dhe lokalë; metodologë, analistët e marketingut, përdoruesit e interesuar në një fushë të caktuar të bujqësisë, shoqatat e fermerëve dhe organizatat e tjera joqeveritare, bizneset private dhe fermerët;
 3. Përdoruesit që kanë interes kërkimor si p.sh. komuniteti shkencor - profesorë dhe studiues, universitete dhe institucione kërkimore, konsulentë dhe studiues në agjencitë qeveritare dhe sektorin privat, ekspertë të statistikave bujqësore dhe studentë.
- Në Ligjin nr. 30/2022 është e parashikuar se në periudhën pesëvjeçare 2022 - 2026 parashikohet të realizohet Censi i Bujqësisë, duke shfrytëzuar informacionin e mbledhur gjatë censit të popullsisë dhe banesave lidhur me ndërtimin e kornizës së njësive ekonomike bujqësore që do të jenë fokus i tij. Censi i Bujqësisë është prioritet kryesor lidhur me përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj. Përditësimi i regjistrit statistikor të fermave dhe përgjithësimi i rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar do të bazohet në kriteret metodike të rekomanduara nga EUROSTAT-i.
- Vrojtimi i strukturës së fermave është një vërtetim i gjerë statistikor i planifikuar, organizuar dhe zbatuar duke u mbështetur në kritere të përcaktuara shkencore e bashkëkohore, për grumbullimin, përpunimin dhe botimin e të dhënave. Vrojtimi ofron të dhëna mikro për aspektet e përgjithshme, të tilla si: struktura e tokës, blegtoaria, fuqia punëtore bujqësore dhe aktivitete të tjera fitimprurëse, masat e zhvillimit rural, makineritë dhe pajisjet, ujëjtja, strehimi i kafshëve dhe administrimi i plehut organik, menaxhimi i tokës, vreshtat dhe drufrutorët.

Këto të dhëna janë baza statistikore për statistikën e tjera mbi përdorimin e tokës, të ardhurat nga blegtoaria dhe bujqësia.
- Indeksi i çmimeve ofron informacion mbi ecurinë e çmimeve të produkteve bujqësore të prodhuesve dhe çmimin e blerjes së mjeteve për prodhimin bujqësor.
- Mjetet bazë për matjen e ndryshimeve të çmimeve dhe ecurinë e çmimeve janë çmimet absolute bujqësore nga njëra anë dhe indekset e çmimeve bujqësore nga ana tjetër. Përdorimi kryesor i çmimeve absolute bujqësore shërben për të krahasuar nivelet e çmimeve midis shteteve dhe për të studiuar zhvillimet e çmimeve dhe ndikimin mbi të ardhurat bujqësore. Indeksi i çmimeve bujqësore tregon ecurinë e çmimeve sipas muajve dhe sezonit. Çmimet mbledhen sipas vërtetimeve mujore dhe tremujore për produktet bujqësore dhe blegtorale, si dhe inputet. Çmimet e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale mbledhen rregullisht çdo muaj.

- Llogaritë ekonomike të bujqësisë dhe statistikave të çmimeve bujqësore luajnë një rol kyç në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të përbashkëta bujqësore, si dhe në vlerësimin e PBB-së dhe gjendjes ekonomike të bujqësisë në vend. Llogaritë ekonomike në bujqësi janë llogari satelitore që furnizojnë llogaritë kombëtare me informacione shtesë dhe koncepte që i përshtaten natyrës së veçantë të “industrisë” të bujqësisë dhe pylltarisë. Vlerësimet për mbjelljet e reja në pemëtarinë për llogaritjen e formimit bruto të kapitalit fix bëhen nga të dhënat statistikore, por dhe nga të dhënat administrative të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të dhënat statistikore kanë shërbyer si një burim kryesor për llogaritjen tremujore dhe vjetore të llogarive ekonomike në bujqësi.
- Të dhënat janë gjithëpërfshirëse për të gjithë aktivitetin bujqësor që ushtrohet në vend dhe të nevojshme për përpunim dhe publikimin e statistikave të prodhimit bimor. Publikimi i statistikave të prodhimit bimor bëhet brenda muajit korrik të vitit pasardhës në faqen zyrtare të INSTAT-it dhe në botimet e dedikuara “Vjetari statistikor i bujqësisë”, “Vjetari rajonal” dhe “Vjetari statistikor” – kapitulli “Bujqësia”. Të dhënat e publikuara janë në nivel vendi, rajoni dhe bashkie.
- Vrojtimet kryhen nga INSTAT-i në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Vrojtimet kanë periodicitet vjetor dhe në kampionim përfshihen të gjithë personat fizikë apo juridikë që ushtojnë aktivitet bujqësor. Prodhimi i mishit llogaritet nëpërmjet të dhënave nga burimi administrativ dhe vrojtimi statistikor vjetor në fermat blegtorale, ku grumbullohet informacion për numrin e kafshëve të therura gjatë vitit kalendarik, pesha mesatare e gjallë dhe pesha mesatare e therur sipas kategorive të kafshëve, si dhe nga anketat mujore në thertore. Parashikimi i prodhimit të mishit (për konsum njerëzor), do të llogaritet duke shfrytëzuar të dhënat statistikore të marra nga vrojtimet statistikore për blegtorinë, therjet, tregtinë e jashtme të kafshëve të gjalla dhe burime të tjera informacioni. Për shpendët grumbullohen të dhëna mujore dhe vjetore në lidhje me numrin e shpendëve të therur në thertore dhe për prodhimin e vezëve nga fermat e shpendëve, të cilat rrisin shpendë për prodhim vezësh për konsum njerëzor⁷.
- INSTAT-i mbledh, përpunon dhe publikon statistikave të llogarive ekonomike të bujqësisë dhe mjedisit bazuar në informacionin statistikor të marrë nga burimet administrative lidhur me statistikave të blegtorisë dhe peshkimit; statistikave të tokës dhe prodhimit bimor; statistikave të mjedisit dhe informacionin e marrë nga vrojtimet statistikore të zhvilluara nga INSTAT-i. Bujqësia ka qenë dhe është një nga veprimtaritë ekonomike më të rëndësishme për vendin tonë.
- Dimensionin social në fushën e bujqësisë përfshin gjithashtu edhe kushtet e jetesës së fermerëve dhe popullsisë rurale, si dhe aspektet arsimore dhe gjinore. Këto aspekte nuk kanë qenë në fokusin e statistikave tradicionale bujqësore, por në këndvështrimin e zhvillimit të politikave evropiane është e mundur të fitojnë rëndësi në të ardhmen. Kështu, statistikave bujqësore duhet të zhvillohen drejt përfshirjes në vjeljen e informacionit statistikor më gjërësisht mbi dimensionin social të bujqësisë.

⁷ Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”, fq. 36.

Deri më tani në fushën e statistikave është operuar në bazë të një kuadri legjislativ si në vijim:

➤ **Ligje**

1. Ligji nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”;
2. Ligj nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”.

➤ **Vendime të Këshillit të Ministrave**

1. Vendimi nr. 53, datë 21.1.2015 “Për kryerjen e disa aktiviteteve statistikore nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2012 - 2016”;
2. Vendimi nr. 3/2023 “Për miratimin e Planit Vjetor 2023 “Për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”;
3. Vendimi nr. 304, datë 9.5.2012 “Për përbërjen dhe detyrat e Komisioneve të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore në Bashki dhe Komuna”;
4. Vendimi nr. 551, datë 22.8.2012 “Për miratimin e kriterëve për përzgjedhjen, rekrutimin e trajnimit e personelit të regjistrimit, si dhe përcaktimin e detyrave e të përgjegjësisë të personelit të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore”;
5. Vendimi nr. 15/2024 “Për miratimin e Planit Vjetor 2024 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”;
6. Vendimi nr. 29/2025 “Për miratimin e Planit Vjetor 2025 “Për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”.

➤ **Akte të tjera ligjore**

1. Memorandum Mirëkuptimi INSTAT nr. 830, datë 3.5.2023, MBZHR nr. 2609, datë 3.5.2023.

PROBLEMI NË SHQYRTIM

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*
- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Problemi është i natyrës rregullatore, pasi ka të bëjë me mungesën e një ligji të posaçëm i cili në njërin anë përmbush kërkesën për përafrim të legjislacionin shqiptar ndërsa në anën tjetër bën të mundur ngritjen dhe funksionimin e një mjedisi efikas, të besueshëm adekuat për vjeljen, përpunimin dhe trasmetimin e një bazë solide të të dhënave statistikore në fushën e bujqësisë.

Aktualisht bujqësia mbetet dega bazë e ekonomisë së vendit, për disa arsye:

- a. përqindja e madhe e popullsisë që banon në rajonet bujqësore ka burim kryesor të ardhurat nga veprimtaria bujqësore;
- b. niveli i ulët i industrializimit.

Objektivi i përgjithshëm i bujqësisë është rritja e qëndrueshme e prodhimit, duke arritur:

- a. përmirësimin e furnizimit të tregut për konsum dhe të subjekteve përpunuese;
- b. zvogëlimin e raportit eksport - import;
- c. rritjen e nivelit ekonomik të familjeve bujqësore etj.

Vlerësimi i sistemit të statistikave bujqësore tregoi se problematika shtrihet në fusha siç janë:

1. Boshllëku ligjor në legjislacionin aktual për statistikave bujqësore;
2. Sistemi ekzistues jo i plotë i statistikave bujqësore;
3. Mbledhja e të dhënave nuk është në lartësinë e duhur;
4. Statistikat nuk prodhohen në mënyrë më efikase.

1. Boshllëku ligjor në legjislacionin aktual për statistikave bujqësore

Ndryshimet klimatike dhe efektet e tjera mjedisore janë në ndryshim të vazhdueshëm duke bërë që edhe bujqësia të jetë në ndryshim të vazhdueshëm për pasojë. Politikat e BE-së evoluojnë si reagim për t'iu përshtatur ndryshimeve të tilla duke sjellë propozimin dhe hartimin e politikave prioritare bujqësore, ekonomike dhe sociale. Kjo krijon nevojën të reja për të dhëna statistikore mungesa e të cilave do të ndikonte drejtpërdrejt në politikat e BE-së që varen nga statistikave bujqësore. Sistemi i statistikave për bujqësinë në BE është i rregulluar përmes rregulloreve të cilat parashikojnë në mënyrë të detajuar procesin e marrjes së të dhënave, përpunimin e tyre dhe vënien në dispozicion të përdoruesve në mënyrë që të shërbejnë efektivisht nevojave të tregut evropian. Në Shqipëri, synohet të ndiqet i njëjti model, kjo jo vetëm sepse është parashikim ligjor dhe kusht për plotësim për anëtarësimin në BE por sepse para së gjithash kjo forcon kuadrin ligjor shqiptar, forcon dhe zhvillon ekonominë si tërësi dhe shërben për bashkëpunimin me shtetet e tjera në rrafshin ndërkombëtar duke përfutur maksimalisht nga kjo marrëdhënie në fushën e bujqësisë. Legjislacioni aktual për statistikave bujqësore nuk i plotëson në mënyrë adekuate nevojat e reja dhe të reja për të dhëna, sepse statistika të tilla nuk përfshihen si kërkesë në aktet ligjore. Aktet nuk janë gjithashtu fleksibël dhe të integruar sa duhet për t'iu përgjigjur menjëherë nevojave të reja. Aktualisht, në Shqipëri ekziston një sistem kombëtar informacioni dhe një regjistër në fushën e bujqësisë, megjithatë funksionimi i tyre nuk garanton përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave sipas standardeve europiane. Ligji parashikon krijimin e regjistrit, por nuk siguron zbatimin efektiv dhe përditësimin e tij në përputhje me Rregulloren që përafrohet me BE-në. Për pasojë, të dhënat statistikore që ofron INSTAT për bujqësinë janë të kufizuara dhe nuk arrijnë nivelin e detajimit, sofistikimit dhe gjithëpërfshirjes që kërkon modeli evropian”.

Grupet e prekura nga ky problem

Fermerët përballen me ulje të rendimentit dhe mundësi të kufizuara për zhvillim si pasojë e mungesës së informacionit të duhur, real mbi të cilin të mbështesin planet afatshkurtra apo afatgjata në investimet e ardhshme, duke i bërë ata kështu më të varur nga subvencionet dhe

ndihmat e jashtme. Qeveria ka vështirësi në politikëbërje dhe aplikimin ligjor adekuat të zhvillimit rural për shkak të mungesës apo sigurisë së ulët mbi të dhënat statistikore që nevojiten gjatë zhvillimeve të planeve sidomos atyre afatgjata në bujqësi. Mungesa e bazës së të dhënave statistikore sjell pasojat direkte dhe indirekte, që janë të rënda dhe çënojnë prioritetet dhe synimet e vëndit tonë, por edhe të vetë BE-së, të tilla si ulja e sigurisë ushqimore, ulja e efektivitetit të masave të ndërmarra ndaj ndryshimeve klimatike dhe shpërdorimi i fondeve të PPB.

2. Sistemi i Statistikave Bujqësore i paplotë dhe joefikas

Problematika e një sistemi të paplotë dhe joefikas të statistikave bujqësore në Shqipëri është një çështje me ndikim të gjerë, që ndikon në politikat publike, zhvillimin rural dhe planifikimin e investimeve në sektorin bujqësor. Sistemi i statistikave bujqësore nuk është mjaftueshëm fleksibël dhe nuk reagon shpejt ndaj nevojave të reja. Kjo ndodh për disa arsye siç janë metodat jo koherente që përdoren aktualisht për mbledhjen e statistikave, kuadri rregullator i paplotë si dhe mungesë e urimeve njerëzore apo e mbështetjes financiare për zhvillimin e proceseve të censusit.

Progresi i zhvillimit teknik dhe organizativ i çalë, ndryshimet shoqërore si dhe rritja e mospërgjigjeve të anketave do të vazhdojnë të ndikojnë në cilësinë dhe efektivitetin e statistikave zyrtare në bujqësi.

Probleme kryesore që has sistemi aktual i statistikave bujqësore në Shqipëri:

a) Strukturë e vjetëruar dhe mungesë fleksibiliteti

- Sistemi ekzistues nuk përshtatet me shpejtësi ndaj nevojave të reja për të dhëna, si p.sh. ndikimi i ndryshimeve klimatike, digjitalizimi në bujqësi, apo kërkesat e BE-së për klasifikime të reja statistikore.
- Natyra e decentralizuar dhe jo gjithmonë e koordinuar e mbledhjes së të dhënave ndikon cilësinë, saktësinë dhe përdorshmërinë e tyre.

b) Mungesa e kapacitet teknik dhe njerëzor

- Mungesa e burimeve njerëzore të trajnuara për mbledhjen, analizën dhe interpretimin e statistikave është një sfidë e vazhdueshme.
- Burimet buxhetore të kufizuara pengojnë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve moderne të mbledhjes së të dhënave (p.sh. regjistrat elektronikë të fermave, përdorimi i GIS në bujqësi, etj).

c) Infrastrukturë e dobët teknologjike dhe metodologjike

- Ka mungesë të instrumenteve të avancuara për mbledhjen dhe analizën e të dhënave (si sistemet digjitale, anketat elektronike, etj).
- Metodologjitë e përdorura janë jo koherente, duke mos reflektuar dinamikën e strukturave të prodhimit bujqësor apo nevojat për të dhëna të detajuara në kohë reale.

ç) Norma të larta të mospërgjigjes

- Niveli i lartë i mos marrjes pjesë të fermerëve në anketat statistikore – shpesh për shkak të mungesës së besimit ose mungesës së informacionit mbi rëndësinë e statistikave – ndikon në cilësinë e të dhënave.
- Ndryshimet shoqërore dhe demografike, si plakja e popullsisë rurale dhe emigrimi, e vështirësojnë më tej këtë proces.

3. Pasojat e sistemit të paplotë dhe joefikas

- Mungesa e informacioni të saktë për madhësinë reale të sektorit, të ardhurat, prodhimin dhe problemet e terrenit ndikon negativisht gjatë procesit të zhvillimit të politikave.
- Mospërdorimi i plotë i fondeve të BE-së për bujqësinë, për shkak të mungesës së statistikave për të justifikuar ndërhyrjet.
- Vështirësi për të ndjekur progresin në zbatimin e reformave në bujqësi dhe zhvillimin rural.
- Mungesë transparence dhe përgjegjshmërie publike, pasi nuk ka të dhëna të sakta për t'u raportuar qytetarëve dhe investitorëve.

Grupet e prekura nga ky problem

- Fermerët dështojnë të bëjnë parashikime, projekte afatgjata investimesh në aktivitetin e tyre bujqësor me pasojë pamundësinë e rritjes së aktivitetit të tyre, prodhimin dhe cilësinë, duke u bërë si pasojë më të varur nga importet për të plotësuar kërkesat e tregut.
- Fermerët shpesh nuk kanë qasje në informacionin mbi praktikën e mira bujqësore, teknologjitë moderne, gjë që e bën të vështirë për ta të përballen me kërkesat e tregut.
- Industria përpunuese nuk merr informacionin që i nevojitet për ndërmarrjen e nismave të reja për zhvillimin e tyre, rritjen e prodhimit, zgjerimin e aktivitetit etj., duke ndikuar negativisht në të ardhurat dhe konkurrencën në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.
- Qeveria has në paaftësi për t'iu përgjigjur nevojave të reja për zhvillimin në fushën e të dhënave statistikore në bujqësi situatë kjo e cila sa më shumë që zgjat atë më të rënda janë efektet në zbatimin e politikave adeguate, reputacionin dhe pozicionin e Shqipërisë në një rend global i cili paraqitet gjithmonë e më dinamik.

3. Mbledhja e të dhënave nuk përmbush standardet e nevojshme

Procesi i mbledhjes së të dhënave nuk është i mjaftueshëm, i harmonizuar me rregulloret e Bashkimit Europian në fuqi. Kjo ndodh sepse po shfaqen nevoja të reja për të dhëna në një kur legjislacioni është zhvilluar me hapa të ngadaltë dhe jo i plotë përgjatë viteve në një kohë kur përkufizimet dhe konceptet ndryshojnë disi ndërmjet zonave bujqësore duke sjellë shtimin e sasisë së të dhënave statistikore jo cilësore dhe të mbledhura përmes metodave jo të duhura.

Grupet e prekura nga ky problem:

- Fermerët nuk të bëjnë parashikime afatgjata investimesh në aktivitetin e tyre duke mos marrë rezultate të kënaqshme dhe duke i kufizuar në zhvillim;
- Industria përpunuese nuk merr të dhënat që i nevojitet për zhvillimin e mëtejshëm duke ndikuar negativisht në rritjen e të ardhurave dhe ulur fuqinë konkurruese.
- Qeveria: mosrealizim të objektivit përfundimtar për përforcimin e kuadrit ligjor, rritjen ekonomike, përshejtimin e procesit të anëtarësimit në BE.

4. Statistikat nuk prodhohen në mënyrë efikase

Statistikat mund të mblidhen dhe përpunohen në mënyrë më efikase nëse legjislacioni përshtatet për të përfshirë burime të ndryshme informacioni dhe nëse Shqipëria përshtatet me teknologjinë moderne, në aspektin e ndërtimit të një sistemi të statistikave në bujqësi, sipas modelit evropian. Procesi i mbledhjes së statistikave bujqësore në Shqipëri shfaq problematika që lidhen kryesisht me fragmentarizmi, mungesa e standardizimit

metodologjik dhe moskoordinimi ndërinstitutional. Të dhënat mbledhen nga burime të ndryshme (INSTAT, Ministria e Bujqësisë, strukturat lokale), shpesh me instrumente të ndryshëm, përkufizime të paqarta dhe intervale kohore të jokonsistente.

Disavantazhe që janë rrjedhojë e këtyre mund të përkufizohen:

- Mungesa e harmonizimit metodologjik sjell pasiguri mbi vlefshmërinë e të dhënave krahasimore ndër vite apo ndër rajone.
- Përdorimi i instrumenteve të ndryshëm për të njëjtat variabla ndikon në krijimin e pasqyrave statistikore kontradiktore.
Një pjesë e këtij problemi buron nga fakti që legjislacioni i statistikave bujqësore ka evoluar ngadalë dhe në mënyrë jo të plotë. Kjo ka sjellë:
- Përkufizime dhe koncepte të paqarta ose të vjetëruara, që nuk përputhen me praktikën më të mira ndërkombëtare (si ato të EUROSTAT apo FAO).
- Mospërputhje mes kuadrit ligjor dhe nevojave të reja të sektorit, sidomos në kontekstin e zhvillimeve të fundit si digjitalizimi, qëndrueshmëria, siguria ushqimore dhe ndërlidhja me politikën e mjedisit dhe klimës.

Grupet e prekura nga ky problem:

- *Fermerët*: Dëmtimi i mundësive për rritje dhe zhvillim duke krijuar varfëri persistente në zonat rurale.
- *Shoqëria Civile*: nuk përfiton nga zhvillimet në bujqësi të cilat në vëndin tonë kanë impakt të drejtë për dtrëjtë në shëndet, ekonomi dhe mjedis.
- *Qeveria*: Përballet me sfida për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe për të menaxhuar burimet natyrore dhe për të plotësuar kushtet e anëtarësimit në unionin evropian.

Të gjithë këta faktorë kanë çuar në përfundimin se politika përkatëse për statistikën bujqësore duhet të hartohet dhe të funksionojë si një sistem i vetëm, ku pjesët përshtaten së bashku dhe bëjnë të mundur që produkti përfundimtar të justifikojë përmes cilësisë dhe efektivitetit koston financiare. Statistikat bujqësore gjithashtu duhet të përshtaten pa hasur në probleme me SSE, të dhënat duhet të jenë të burimeve të ndryshme marrë nga një fushë e gjerë informacioni duke përdorur metoda krahasimore mes tyre e që do të përdoren aty ku është e mundur dhe e domosdoshme. Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit si edhe teknologjitë e tjera të reja (p.sh. të dhënat dhe inovacionet e bazuara në kërkime) duhet të integrohen në procesin e mbledhjes së të dhënave. Efikasiteti i metodave të mbledhjes së të dhënave duhet të vlerësohet në raport me nevojat për të dhënat të cilat plotësojnë kriteret e cilësisë.

Grupet e prekura nga këto problematika, në tërësi, janë:

Grupet e ndikuar janë:

o Qeveria;

o Operatorët e Bizneseve;

o Fermerët;

o Shoqëria civile;

o Punëmarrësit.

Problemi mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave duke hartuar një kornizë solide të vetme ligjore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin*
- *Rendisni punën egzistuese që është realizuar tashmë.*

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të përditësohet sistemi statistikor i të dhënave në nivele moderne dhe me cilësi sipas modelit evropian, i cili para së gjithash i shërben publikut dhe së dyti plotëson nevojën e bashkëpunimit në rang ndërkombëtar në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së.

Kjo nismë do të fuqizojë rolin e INSTAT si një pjesëtar aktiv në sistemin statistikor në vend, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare. Për të ndërtuar një sistem informativ statistikor të qëndrueshëm, në gjendje të aplikojë standardet moderne ndërkombëtare, INSTAT synon të intensifikojë marrëdhëniet jo vetëm me institucionet e ngjashme të vendeve anëtare të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara, por edhe me organizatat ndërkombëtare në të cilat aderojnë. Duke u bërë pjesë e këtyre organizatave si dhe duke luajtur rol aktiv nëpërmbushjen e misionit që ata kanë, INSTAT-it do t'i mundësohet të jetë i përditësuar me metodologjitë dhe praktikat më të mira statistikore të aplikuara. Marrëdhënia ndër-institucionale me institucionet e ngjashme të vendeve të tjera është mekanizëm i domosdoshëm për të ruajtur koherencën dhe mundësuar aplikimin e standardeve më të fundit të prodhimit statistikor si dhe për të përfutur nga eksperiencat e institucioneve respektive duke shmangur pengesat e hasura dhe zgjidhur problematikat. Për këtë qëllim, duke gjetur vullnetin ndërmjet palëve, INSTAT ka për objektiv nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e ngjashme të vendeve të tjera të rajonit dhe më gjerë. INSTAT- ndër të tjera, ka gjithashtu në fokus përmirësimin e sistemit të mbledhjes së të dhënave, përpunimin, analizat cilësore dhe shpërndarjen e të dhënave, si dhe përditësimin e metadatave (raporteve të cilësisë).

- Statistikat strukturore të fermës luajnë një rol të rëndësishëm në implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të përbashkëta bujqësore

Ndërhyrja e Qeverisë ka për qëllim trajtimin e problematikave të evidentuara të cilat kanë natyrë rregullatore dhe mund të trajtohen vetëm përmes propozimit të një nisme të re e cila do të shërbejë si një bazë solide për plotësimin dhe funksionimin e kuadrit ekzistues legjislativ.

Ndërkohë, miratimi i kësaj politike që propozojmë është i domosdoshëm për të siguruar kryerjen e aktivitetit “Censi i Bujqësisë”, parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022 - 2026, miratuar me Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”.

Rëndësia e ndërmarrjes së kësaj nisme në Shqipëri, veç të tjerash, paraqitet e tillë sepse shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose aspirante për t'u anëtarësuar, kanë marrë përsipër detyrimin që çështje të së njëjtës natyre t'i trajtojnë bashkarisht (në mënyrë të ngjashme) dhe për këtë nevojitet hartimi, zbatimi, monitorimi, vlerësimi efektiv dhe efikas i politikave, shkëmbimi i të dhënave mes tyre në funksion të nevojave për informacion mbi të gjitha

aspektet e aktiviteteve bujqësore duke dhënë një panoramë të plotë të gjendjes reale në bujqësi si një nga fushat më jetike të BE-së dhe shoqërisë botërore në tërësi.

Veprimi individual nga ana e shteteve anëtare të Unionit apo aspirante për anëtarësim, nuk shërben për realizimin e objektivave të përbashkëta të Unionit. Veprimi është më efektiv nëse ndërmerret në nivel të BE-së, bazuar në një akt ligjor të BE-së i cili siguron krahasueshmërinë e informacionit statistikor në fushat statistikore të trajtuara nga akti i propozuar. Ndërkaq, vetë mbledhja e të dhënave kryhet më së miri nga vet shtetet.

Zhvillimi i Censit në Bujqësi është i nevojshëm sepse është e vetmja mënyrë për të marrë përditësime mbi popullsinë e plotë bujqësore në BE, kështu që fermat e vogla, jo të orientuara nga tregu duhet të përfshihen në cens. Censi është i vetmi instrument për mbledhjen e të dhënave që prodhon informacion statistikor për fermat e vogla, dhe për këtë arsye është një burim thelbësor informacioni statistikor për qeverinë dhe vendimarrësit. FAO gjithashtu kërkon që vendet anëtare të ndjekin udhëzimet, standardet dhe përkufizimet e Programit Botëror për Regjistrimet e Bujqësisë 2020, në mënyrë që të arrihen rezultate të harmonizuara dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar dhe të lejojnë vendet të krahasojnë performancën mes tyre.

Në mënyrë që kjo nismë të funksionojë në zbatim metoda e gjenerimit të të dhënave duhet të jetë e njëjtë si dhe të evidentohet numrat identifikues të fermave. Një identifikim i tillë unik i fermës do të mundësojë gjithashtu lidhjen e pronave të mbuluara nga FADN⁸ me pronat e mbuluara nga FSS⁹. Gjatë zhvillimit të anketimit nga Eurostat-it, i gjithë informacioni strukturor do të duhej të mbledhej vetëm një herë dhe mund të ndahej nga FADN në nivel kombëtar. Kjo mund të adresojë gjithashtu nevojën për të shtuar variabla shitesë në FADN duke i transformuar ato në sondazhe satelitore në EASS-in¹⁰ e ri.

Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

Shqipëria në rrugëtimin drejt anëtarësimit në Unionin European ka marrë angazhimin për zbatimin e kushteve dhe kërkesave të cilat shtrihen në të gjitha fushat e organizimit shoqëror me veçanërisht bujqësinë si gur themeli i ekonomisë shqiptare por edhe të pjesës më të madhe të shteteve të tjera anëtare.

Për këtë qëllim Qeveria është gjithmonë e fokusuar në propozime dhe plotësimit e kuadrit legjislativ për të vënë në zbatim hallkat e zixhirit të zhvillimit me kahje nga BE. Konkretisht, propozimi i kësaj nisme politike ka të bëjë me ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi modern, cilësor, real dhe në kohë i cili jo vetëm do gjenerojë të dhëna të sakta statistikore, që i shërbejnë synimit për zhvillimin e brendshëm, por edhe do të bashkveprojë me sistemet e tjera statistikore, të të njëjtit nivel në funksion të zbatimit të PPB europiane.

1. Përputhshmëria me Angazhimet e Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së

Kjo nismë lidhet ngushtësisht me Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (AGJBP) dhe angazhimet e Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së, pasi ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit agroushqimor dhe të përputhet me standardet e vendosura nga BE për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Axhenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor

⁸ “Farm Accountancy Data Network” Sistem i të dhënave bujqësore që gjenerohet dhe publikohet nga Komisioni European.

⁹ “Farm Structure Survey” Struktura e informacionit mbi fermat, një sistem i mbajtur ky nga të gjithë vendet anëtare të Unionit.

¹⁰ “European Agricultural Statistics” System - Sistemi European i Statistikave Bujqësore.

është një instrument për arritjen e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane në rajonin tonë. Marrëveshja e Gjelbër Evropiane përfaqëson një moment historik në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe një strategji gjithëpërfshirëse të rritjes së Bashkimit, dhe zbatimi i saj duhet të çojë në neutralitetin klimatik të Bashkimit Evropian deri në vitin 2050. Me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes mbi Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor më 10 nëntor 2020, vendet e rajonit u angazhuan për zbatimin e Axhendës së Gjelbër si një “udhërrëfyes” për një sërë veprimesh dhe masash konkrete për të çuar në një zhvillim dhe rritje ekonomike në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Axhenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor mbulon pesë fusha: klimën, energjinë dhe lëvizshmërinë; ekonominë qarkulluese; parandalimin e ndotjes; bujqësia e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit; dhe biodiversitetit.

2. Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural dhe Përputhja me Politikën e BE-së

Kjo nismë lidhet me Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 - 2027 (SBZHRP 2021- 2027). Në SBZHRP 2021 - 2027. Përputhja me standardet e BE-së është një komponent kyç i këtij procesi, dhe kjo nismë kontribuon në këtë aspekt duke përfunduar legjislacionin shqiptar me Rregulloren e BE-së Nr. 2018/1091. Përputhja me standardet e BE-së është një domosdoshmëri për Shqipërinë, sa i takon procesit të integritetit evropian dhe për të përmbushur kërkesat e BE-së për krijimin dhe funksionimin e një sistemi statistikor modern, efikas e mbi të gjitha real me saktësi maksimale në fushën e bujqësisë. Nëpërmjet vendosjes së normave për marrjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, nisma përforcon qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor dhe peshkimit, duke promovuar praktika që japin një panoramë reale të mjedisit bujqësor dhe që sigurojnë përmbushjen e standardeve të BE-së për sigurinë dhe cilësinë statistikore. Kjo i lejon Shqipërisë të integrohet më lehtë në tregjet evropiane, ku respektimi i standardeve dhe siguria e BE-së kanë një avantazh të dukshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përputhja me politikat e BE-së ndihmojnë gjithashtu në rritjen e konkurrencës së produkteve shqiptare dhe fuqizimin e sektorëve ruralë, duke kontribuar në përmirësimin ekonomik të zonave rurale dhe të qëndrueshmërisë së prodhimit bujqësor.

Në përmbledhje, kjo nismë mbështet objektivat kryesore të strategjisë duke përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e bazës së të dhënave statistikore, duke përputhur legjislacionin shqiptar me atë të BE-së, dhe duke promovuar një sektor rural që është konkurrues, i qëndrueshëm dhe në harmoni me kërkesat ndërkombëtare.

3. Zhvillimi i Bujqësisë dhe Fshatit

Nisma lidhet me Programin e Qeverisë 2021-2025, ku Qeveria Shqiptare ka vendosur objektiva dhe synime lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe fshatit. Bujqësia si një pikat kyce të ekonomisë shqiptare është në qendër të politikave të Qeverisë, e cila në këtë këndvështrim ka marrëdhënie rajonale dhe ndërkombëtare me shtet evropiane në fusha të sigurisë ushqimore, kontrollit dhe monitorimit të brendshëm dhe kufitar, rritjen e cilësisë dhe monitorimin e zinxhirit ushqimor, zbatimin e politikave afatshkurtra dhe afatgjata në funksion të zhvillimit të jëtës urale dhe rurale etj. Modernizimi për zhvillim që ne duam të ndërtojmë për Shqipërinë nuk lidhet vetëm me përparimin teknologjik, apo shpërndarjen e informacionit, por lidhet me krijimin e sistemeve që krijojnë mundësi të reja dhe të barabarta, që rrisin shpejtësinë e ndërveprimit dhe cilësinë e prodhimit në fusha kyçe për

rritjen ekonomike e çeljen e vendeve të reja të punës në bujqësi, infrastrukturë, turizëm apo manifakturë¹¹.

Më poshtë po rendisim punën ekzistuese të kryer deri më tani:

Deri më tani në fushën e mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit të të dhënave statistikore në bujqësi është vepruar bazuar në bashkëpunimin mes dy institucioneve siç janë INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Secili institucion ka detyra të mirëpërcaktuara për përmbushjen e së cilave veprojnë në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë për të bërë të mundur më pas bashkëpunimin mes tyre për realizimin e qëllimit final për ofrimin e të dhënave, indikatorëve statistikor në bujqësi.

MBZHR në kuadër të përmbushjes së objektivave të institucionit ka parashikuar ngritjen dhe funksionimin e njësisë përgjegjëse për statistikën Drejtoria e Statistikave, Analizës dhe Raportimeve. DSAR kryen këto funksione:

1. Prodhon informacion të saktë dhe koherent për të mbështetur analizat efektive dhe vendimet e politikëbërjes nga MBZHR.
2. Mbledh, përpunon dhe prodhon indikatorët statistikor vjetor në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë të cilat publikohen në faqen zyrtare të INSTAT.
3. Grumbullon dhe përpunon informacion statistikor të ardhur nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për indikatorët në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agroindustrisë.
4. Kryen vrojtime të ndryshme për grumbullimin e informacionit , përpunimin e të dhënave në lidhje me treguesit statistikor bujqësor për t'iu përgjigjur kërkesave gjithmonë në rritje nga përdoruesit, në bashkëpunim me INSTAT, me fokus edhe përditësimin e Regjistrit të Fermës.
5. MBZHR marr të gjitha masat për ngritjen e rrjetit të kontabilitetit të fermës (FADN), duke krijuar edhe një sektor të posaçëm, konkretisht FADN-së në Drejtorinë e Statistikave, Analizës dhe Raportimeve.

INSTAT në një periudhë dyvjeçare është i angazhuar me punën përgatitore për realizimin e Censit të Bujqësisë, në bashkëpunim me partnerë kombëtarë, si: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financave, etj., dhe me institucione ndërkombëtare si FAO, EU, Banka Botërore, të cilët mbështesin në mënyrë të vazhdueshme me ekspertizë.

Komisioni Evropian ka mbështetur INSTAT-in nëpërmjet asistencës teknike duke u fokusuar në dy komponentë:

1. Aspektet metodologjike, përfshirë përgatitjen e pyetësorit të Censit të Bujqësisë;
2. Zhvillimin e një aplikacioni për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë, duke përdorur metodën CAPI (intervistë personale me ndihmën e kompjuterit).

Një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Statistikave të Francës (INSEE) është nënshkruar në vitin 2024 për ndërtimin e platformës për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë. Versioni i parë i pyetësorit është hartuar duke reflektuar nevojat e informacionit dhe përputhshmërinë me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ndërkohë, janë kryer analiza të ndryshme në funksion të ndërtimit të kornizës për përzgjedhjen e njësisë

¹¹ Programi i Qeverisë 2021-2025.

bujqësore, përfshirë verifikimin dhe ndërlidhjen e të dhënave ndërmjet regjistrave administrativë dhe atyre statistikorë, me qëllim sigurimin e një baze të saktë për mbulimin dhe raportimin statistikor, këtui mund të përmendim: Analizën për shpërndarjen e Njësive Ekonomike Bujqësore sipas Zonave të Censit dhe njësive administrative, bashkive të dala nga Censi 2023.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë siç vijon:

1. Të sigurohet informacion i përgjithshëm dhe i hollësishëm për 98% të sipërfaqes së shfrytësuar nga njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe 3-vjeçare nga momenti i miratimit i nismës;
2. Të ofrohen të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor në Republikën e Shqipërisë brenda një periudhë prej 3 vitesh nga momenti i miratimit të nismës;
3. Të krijohet regjistri statistikor i njësive ekonomike bujqësore në një periudhë prej 2 vitesh nga momenti i miratimit të kësaj nisme.
4. Përafrimi i legjislacionit me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian menjëherë me miratimin e kësaj nisme.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar katër opsionet:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Ky opsion nënkupton qëndrimin në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me ndonjë nisëm të caktuar dhe në këtë mënyrë duke mos dhënë zgjidhje problematikave të evidentuara, mos adresimin e tyre si dhe mos plotësimin e detyrimeve për përafrimin ligjor me BE-së.

Avantazhet:

- Problemet e evidentuara do të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në sektorin e bujqësisë, lidhur me të dhënat kryesore për njësitë ekonomike bujqësore, të cilat datojnë që në vitin 2012 dhe nuk janë koherente për adresimin e problematikave dhe hartimin e politikave të reja konform, politikës së përbashkët evropiane;
- Të dhënat aktuale jo në përputhje të plotë me kërkesat e kohës.

Disavantazhet:

- Problemet e evidentuara do të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në sektorin e bujqësisë, siç janë pamundësia e gjenerimit të statistikave reale, me cilësi të lartë, forcimi i zhvillimit të tregut të brendshëm, rajonal e ndërkombëtar.
- Do të pengohet përmirësimi dhe adoptimi i praktikave të reja dhe teknologjive, duke e bërë sektorin të pazhvilluar dhe të paefikas.
- Nuk plotësohen kushtet për përafrimin e legjislacionit të me atë të vendit.

Opsioni 1 - (rregullator): Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri dhe shfuqizimin e Ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”. Përzgjedhja e këtij opsion siguron që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standartet europiane dhe në të njëjtën kohë përmbushin detyrimin për përafrimin *acquis communautaire* të BE-së me kuadrin ligjor shqiptar.

Avantazhet:

- Miratimi i një ligji të ri mund të sjellë një frymë të re dhe të nxisë besimin te përdoruesit e sistemit informativ statistikor siç janë fermerët, investitorët, mediat etj.
- Një ligj i ri ofron përdorimin e metodave, indikatorëve dhe modele efektive të përshtatshme për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat statistikore duke dhënë një panoramë të qartë të gjendjes në fushën e bujqësisë.
- Kuptueshmëria dhe qartësia juridike arrihet 100% vetëm nëpërmjet hartimit të një ligji të ri.
- Ndryshimet e propozuara prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit aktual dhe për këtë arsye, në kuadër të teknikës legjislative miratimi i një ligji të ri vlerësohet si më optimal.

Disavantazhet:

- Pamundësia për zgjidhjen e problematikave në një kohë të shpejtë. Hartimi i ligjeve të reja zakonisht kërkon një analizë të thellë dhe konsultime me palët e interesuara, si fermerët, ekspertët e sektorit dhe organizatat civile. Kjo mund të shkaktojë vonesa në proces.
- Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri paraqet kosto të larta financiare dhe të burimeve njerëzore dhe kohë të nevojshme për zhvillimin e këtij procesi.

Opsioni 2 - (rregullator): Paraqet mundësinë për rishikimin dhe ndryshimin e dispozitave ligjore në Ligji nr.1 0201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, por nuk rregullon problematikën e evidentuara në fushën e mbledhjes së informacionit në bujqësi duke mos arritur rezultatet e duhura që synohen të arrihen sipas kërkesave të BE-së por edhe nevojave të evidentuara. Ky opsion nuk ofron zgjidhje efektive për problematikën e evidentuara dhe nuk trajton nevojat aktuale të sektorit.

Avantazhet:

- Rishikimi mund të sjellë përmirësime konkrete dhe të adresojë problemet e identifikuar në kohë më të shpejtë se miratimi i një ligji të ri.
- Ruhët një nivel stabiliteti në sektor, pasi ligji ekzistues mbetet në fuqi, duke shmangur pasigurinë që mund të vijë nga shfuqizimi i tij.
- Rishikimi do të përdorë njohuritë dhe eksperiencën e ligjit ekzistues, duke e bërë procesin më të përshtatshëm dhe të bazuar në praktikën e deritanishme.

- Ndryshimet në ligj do të kenë kosto me të ulëta krahasuar me hartimin e një ligji të ri.
- Realizimi i qëllimit kryhet në një periudhë kohore më të shkurtër duke e bërë këtë opsion si opsioni më efikas dhe i shpejtë.

Disavantazhet:

- Rishikimi mund të marrë kohë dhe të vonojë zbatimin e zgjidhjeve për problematikat aktuale.
- Nëse rishikimi nuk është i plotë dhe i thelluar, mund të mos arrijë të adresojë të gjitha çështjet, duke lënë problematika të pazgjidhura.
- Nuk plotësohet kushti për përafrimin e legjislacionit me BE-së dhe nuk kemi një sistem i cili ofron zgjidhjen e ofrimit të produktit përfundimtar maksimalisht optimal të të dhënave statistikore.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit egzistues në fuqi nga strukturat kompetente duke mos ndërmarrë ndryshime ligjore në ligjin aktual dhe duke mos miratuar një projekligj të ri. Ky opsion do ishte trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, analizimi i terrenit më i shpeshtë etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këta sektorë. Ky opsion nuk ofron zgjidhjen e duhur për problematikat e evidentuara dhe as përmbushjen e qëllimeve që ka vënë Qeveria Shqiptare.

Avantazhet:

- Përforcimi e mbikëqyrjes dhe menaxhimit ekzistues të institucioneve përgjegjëse pa ndryshuar legjislacionin.
 - Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, përmes trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të sektorëve.
 - Inkurajimi e fermerëve dhe të shfrytëzuesve të tjerë të tokave bujqësore për zbatimin e metodave të reja inovative duke patur në vëmendje ruajtjen e biodiversitetit dhe cilësinë e pjellorisë së tokës bujqësore pa imponuar rregullore të reja. Kjo do të përfshinte fushata edukative dhe informuese, trajnime intensive jo vetëm për stafin mbikëqyrës e zbatues aktual por edhe fermerin, si dhe ofrimin e burimeve dhe udhëzimeve për të ndihmuar ata gjatë zbatimit të procesit.
- Ky nuk është opsioni më efikas për adresimin e problematikave, pasi parashikimet dhe risitë që sjell propozimi i projekligjit të ri shtrihen në fushën e statistikave në bujqësi, ku përfshihet edhe vet zhvillimi i censit veçanërisht në bujqësi.

Parashikohen institucionet, kompetencat, organet zbatuese, ngritja funksionimi i një sistemi, metodat për vjeljen e informacionit dhe përpunimi i tij, bashkëveprimi me sistemet të tjera, përafrimi i legjislacionit shqiptar me BE-së etj.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*

- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni)*

Grupet e ndikuara nga kjo nismë janë:

- *Qeveria:*
 1. *INSTAT dhe stafi i tij (përfshirë strukturat qendrore dhe lokale të përfshira në zbatimin e censit).*
 2. *Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe institucione të tjera publike që zotërojnë të dhëna administrative.*
 3. *Bashkitë dhe komisionet vendore të censit;*
 - *Operatorët e bizneseve;*
 - *Njësitë ekonomike bujqësore - (fermerë individualë, familje bujqësore, sipërmarrje bujqësore që tregtojnë ose jo);*
 - *Shoqëria civile;*
 - *Kërkues shkencorë dhe përdorues të statistikave zyrtare;*
 - ***Shoqëria në tërësi/qytetarët** (si përfitues të të dhënave statistikore për politika dhe planifikim).*
 - *Qeveria - kjo nismë parashikohet të sjellë rritje të punësimit, plotëson kushtet lidhur me përafrimin e legjislacionit, forcon marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rajonale për zbatimin e PPB, ofron informacion statistikor në bujqësi të saktë, real dhe efikas, rritet besimi te përdoruesit etj. Qeveria në të njëjtën kohë forcon institucionet e saj në nivel qendror dhe lokal, përkatësisht:*
 - a) *INSTAT:*

Ndikime të drejtpërdrejta

 - *Sociale - rritje e përgjegjësisë institucionale dhe rritje e besimit të publikut për të dhëna statistikore të cilësisë së lartë dhe konfidencialitetin e të dhënave.*
 - *Ekonomike/financiare - kosto e konsiderueshme për përgatitjen, zbatimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave të censit (burime njerëzore, IT, logjistikë).*

Ndikime jo të drejtpërdrejta

 - *Ndikimi i rezultateve të censit për të forcuar rolin e INSTAT si institucion profesional dhe i besueshëm në nivel kombëtar e ndërkombëtar.*
 - b) *Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe institucione të tjera shtetërore:*

Ndikime të drejtpërdrejta

 - *Financiare dhe administrative - detyrimi për të ofruar të dhëna administrative pa kosto financiare gjë që kërkon angazhim teknik dhe organizativ për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e tyre.*

Ndikime jo të drejtpërdrejta

 - *Përfitime nga përdorimi i të dhënave për përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional dhe planifikimin hapësinor.*
 - c) *Bashkitë dhe komisionet vendore të censit:*

Ndikime të drejtpërdrejta

- Sociale dhe organizative - angazhim në zbatimin lokal të censit, përfshirë burimet njerëzore dhe logjistike.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

- Përfitime nga përdorimi i të dhënave për hartimin e planeve zhvillimore dhe vendimmarrjen në nivel vendor.

ç) Përdoruesit e të dhënave statistikore (kërkues shkencorë, institucione, investitorë, shoqëri civile):

Ndikime të drejtpërdrejta (pozitive)

- Sociale - përdorimi nga qasja në të dhëna të detajuara për qëllime hulumtuese dhe akademike;
- Përdoruesit e të dhënave, siç janë drejtoritë e përgjithshme të politikave të Komisionit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe të tjerë, ju ofrohen të dhëna statistikore bujqësore më të mira, më fleksibile dhe të integruara, si dhe më të harmonizuara dhe koherente për t'i shërbyer nevojave të tyre të hartimit të politikave, monitorimit, vlerësimit, kërkimit dhe nevojave të tjera. Kjo nevojë me ecurinë e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE vjen gjithmonë e më shumë në rritje;
- Përdoruesit institucionalë kanë interes në fushëveprimin e statistikave bujqësore gjatë hartimit të politikave bujqësore duke i shfrytëzuar këto të dhëna për shumë arsye siç janë hartimi i politikave adeguate lidhur me fusha të caktuara të bujqësisë, kufizimin e barrës administrative/ekonomike për biznesin etj.;
- Prodhuesit e të dhënave si INSTAT, institucione të tjera që përdorin të dhënat statistikore në vend apo edhe EUROSTAT, që kryejnë anketat statistikore dhe detyra të tjera të mbledhjes, prodhimit dhe shpërndarjes së të dhënave kanë interes të mbajnë kostot e prodhimit të statistikave bujqësore në të njëjtin nivel ose t'i ulin ato, të përmirësojnë proceset dhe rezultatet e tyre të prodhimit, si dhe të marrin fonde nga BE-ja për mbledhjen e të dhënave.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

- Rritje e transparencës dhe bazë më e mirë për advokim apo planifikim politikash.
- Fermerët dhe bizneset bujqësore duke qenë se preken nga zbatimi i politikave, kanë interes të ulin kostot dhe burokracinë administrative, dhe të ruajnë financimin e tyre nga BE-ja, i cili varet indirekt nga statistikën me cilësi të lartë.

d) Shoqëria si tërësi:

Ndikime jo të drejtpërdrejta (pozitive)

- Sociale/ekonomike - hartimi i politikave të targetuara mbi zhvillimin rural dhe bujqësor që mbështesin mirëqenien dhe punësimin.
 - Financiare - efektivitet më i lartë në shpërndarjen e burimeve publike për zhvillimin e bujqësisë.
 - Mjedisore - të dhëna më të mira për ndikimin e bujqësisë mbi mjedisin dhe për planifikimin e qëndrueshëm.
- *Operatorët e bizneseve* - preken nga ky ligj, pasi ligji parasheh normim të ri, vihen në dijeni për të gjitha të dhënat lidhur me aktivitetet etj.
- *Fermerët* - do të aplikojnë metoda të reja të raportimit të informacionit, rritje e fuqisë konkurruese në tregun e brendshëm, mundësinë e eksportit apo rritjen e eksportit, përmirësimin e kushteve të zhvillimit të veprimtarisë bujqësore për ta etj.

- *Shoqëria civile* - intensifikimi, zgjerimi dhe modernizimi i bujqësisë përforcon ofertën ekonomike dhe sociale në ato zona, duke sjellë një jetesë më të mirë për banorët ruralë, duke u ofruar të rinjve një mundësi më tepër punësimi dhe një ofertë ekonomike tërheqëse, dhe kështu edhe produkte më të mira dhe siguri më të lartë ushqimore etj.

Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të hartimit të projektligjit të ri:

1. Ndikimet Sociale:

Hartimi i projektligjit “Për Censin në Bujqësi” do të krijojë një bazë të dhënash të plotë dhe të përditësuar për sektorin bujqësor, duke mundësuar planifikimin dhe zbatimin më efektiv të politikave kombëtare në përputhje me standardet e BE-së. Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore do të jenë të tërthorta dhe varen nga mënyra se si këto të dhëna do të përdoren për të përmirësuar politikat, investimet, standardet dhe partneritetet tregtare.

1. Punësimi dhe kushtet e punës

- Të dhënat mund të ndihmojnë qeverinë të identifikojë nevojat për trajnim profesional të fermerëve dhe punonjësve sezonalë.
- Mund të përmirësojnë targetimin e skemave të mbështetjes për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale.
- Mund të nxiten politika që mbështesin punësimin formal, duke ndihmuar që punonjësit të dalin nga informaliteti.

Në vetvete censusi nuk gjeneron vende pune, por ndihmon politikat që i gjenerojnë.

2. Ndikime ekonomike indirekte

a) Rritja e standardeve të prodhimit dhe përpunimit

- Duke pasur të dhëna më të sakta, shteti mund të hartojë politika standardizimi, certifikimi dhe të sigurisë ushqimore.
- Operatorët ekonomikë mund të përdorin të dhënat për analiza tregu, identifikim tregjesh të reja dhe plane investimi.

b) Partneritete dhe tregje të reja

- Institucionet mund të përdorin të dhënat për të negociuar marrëveshje tregtare ose për të përafshuar standardet me BE-në.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar lehtësohet sepse të dhënat statistikore janë një “valutë besueshmërie” për investitorë të huaj.

c) Përdorimi i të dhënave për tërheqjen e investimeve

- Bizneset mund të analizojnë të dhënat për të parë ku ka potencial për zhvillim, kultura bujqësore, infrastrukturë ujësjellëse apo përpunim, agro-turizëm.

3. Ndikime mjedisore indirekte

a) Politika më të sakta për mbrojtjen mjedisore

- Të dhënat ndihmojnë në monitorimin e përdorimit të pesticideve, fertilizuesve dhe ujit.
- Mund të orientojnë politikat për bujqësi të qëndrueshme dhe praktika të agrobujqësisë.
- Mund të mbështesin plane për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

4. Ndikime për administratën publike

a) Menaxhim më i mirë i burimeve financiare

- Shteti mund të alokojë fondet e subvencioneve, grantet dhe mbështetjen financiare bazuar në të dhëna reale, jo në supozime.
- Zvogëlohet abuzimin apo shpërdorimin e skemave të mbështetjes.

5. Harmonizim me standardet e BE-së

- Të dhënat i japin mundësi Shqipërisë të raportojë sipas standardeve EUROSTAT dhe FAO, që është kusht për politikat e përbashkëta bujqësore në kuadër të integritetit.

Të gjitha këto ndikime janë indirekte, sepse ato varen 100% nga përdorimi:

- Nëse të dhënat nuk përkthehen në politika, nuk ka ndikim real.
- Nëse qeveria nuk i përditëson, nuk i analizon dhe nuk i shpërndan te aktorët relevantë, nuk gjenerohet vlerë.
- Nëse bizneset nuk i përdorin për planifikim tregu, nuk sjellin rritje konkurruese.

ç. Kosto dhe Përfitime

Kosto të drejtëpërdrejta në sektorin publik:

- Censusi kërkon fonde të mëdha për organizimin, trajnimin e anketuesve, teknologji, logjistikë dhe analizë të të dhënave të specifikuar në zëra në tabelën përkatëse¹².
- Angazhohen një numër i konsiderueshëm punonjësish të administratës dhe specialistësh për një periudhë të gjatë.
- Menaxhimi i saktë i procesit është sfidues, sidomos në zona të thella rurale apo me akses të kufizuar.
- Edukimi dhe trajnimi mund të paraqesin kosto, të cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me këtë nismë, pasi inovacionet teknologjike kërkojnë një nivel të caktuar njohurish dhe aftësish nga fermerët.
- Për të realizuar potencialin e plotë të teknologjive inovative në bujqësi, është e rëndësishme të investohet në edukimin e fermerëve, të mbështetet kërkimi shkencor dhe të krijohen politika që inkurajojnë adoptimin e teknologjive të reja. Prandaj, programet e edukimit dhe trajnimeve janë të domosdoshme për të maximizuar përfitimet nga këto teknologji.

Përfitime ekonomike të sektorit publik: Megjithëse ka disa kosto, përfitimet afatgjata të censusit të bujqësisë në Shqipëri i tejkalojnë dukshëm këto kosto, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Të dhënat e përfuara ndihmojnë në modernizimin e sektorit bujqësor, në rritjen e konkurrueshmërisë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm rural.

- Qeveria merr një pasqyrë të qartë mbi strukturën e bujqësisë (sipërfaqet e mbjella, numrin e fermave, përdorimin e tokës, mekanizimin, fuqinë punëtore, etj);
- Harton politika bujqësore më të sakta dhe efektive;
- Të dhënat ndihmojnë për të planifikuar investime publike në infrastrukturë rurale, ujitje, subvencione apo skema mbështetjeje;
- Censusi zhvillohet sipas standardeve të Eurostat, çka ndihmon Shqipërinë në procesin e integritetit europian;
- Mundëson zhvillimin e politikave të synuara për zona të caktuara ku bujqësia ka potencial të lartë apo ku ka nevojë për ndërhyrje.

¹² Shih faqe 36.

- Aktualisht nuk evidentohet mundësia për përlllogaritjen e përfitimeve sasiore për sektorin publik si rezultat i miratimit të kësaj nisme, kjo qoftë edhe në mënyrë të përafërt.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin privat:

Kosto të drejtpërdrejta të sektorit privat: nuk paraqiten kosto ekonomike për përdoruesit e bazës së të dhënave sipas parashikimeve të kësaj nismë.

Kosto jo të drejtpërdrejta në sektorin privat: identifikohen disa kosto jo të drejtpërdrejta siç janë:

- Fermerët dhe subjektet bujqësore duhet të ndajnë kohë për të marrë pjesë në anketë, gjë që mund të ndërpresë aktivitetet e tyre ditore kostot ekonomike që mund të konstatohen si pasojë e pezullimit të përkoshëm të aktivitetit ekonomik janë të pamundura të evidentohen ne terma sasiore qoftë kjo edhe në mënyrë të përafërt për shkak së variojnë rast pas rasti në varësi të madhësisë të subjektit bujqësor, numri i personelit të tyre, organizmi i brendshëm etj.
- Disa fermerë mund të kenë rezerva për të ndarë informacion mbi prodhimin apo të ardhurat e tyre, duke rritur hezitimin.

Përfitimet ekonomike për sektorin privat:

- Agrobizneset dhe fermat mund të analizojnë tregun dhe konkurrentët përmes statistikave të qarta;
 - Investitorët mund të identifikojnë zona me potencial për zhvillim bujqësor apo agro-industrial;
 - Bankat dhe institucionet financiare përdorin të dhënat për të zhvilluar produkte të përshtatura për sektorin bujqësor (kredi, sigurime bujqësore, etj.);
 - Kompanitë që merren me shpërndarje inputesh apo tregtim produktesh bujqësore mund të targetojnë më mirë fermerët.
- Aktualisht nuk evidentohet mundësia për përlllogaritjen e përfitimeve sasiore për sektorin privat si rezultat i miratimit të kësaj nisme, kjo qoftë edhe në mënyrë të përafërt.

Kompleksiteti i përfitimeve ekonomike

- Sektori privat:

Përfitimet e fermerëve, operatorëve bujqësorë, përdoruesve të të dhënave varen nga faktorë që aktualisht janë të paparashikueshëm, si:

- Kapaciteti i tregut dhe zhvillimet ekonomike të cilat janë dinamike në këtë sektor.
- Rritja e tregtisë dhe ndikimi i saj në çmime dhe konkurrencë.
- Përdorimi i të dhënave statistikore si mënyrë për të tërhequr investitorët e jashtëm.

Sektori publik:

Përfitimet si rritja e të ardhurave nga bujqësia, rritja e punësimit dhe kontributet në sigurimet shoqërore dhe shëndetësore varen nga efektiviteti i përdorimit të të dhënave statistikore për qëllime të zhvillimit apo për të tërhequr investitorë të jashtëm.

4. Pamundësia për përlllogaritje të sakta në mungesë të të dhënave konkrete

Në këtë fazë nuk ka të dhëna të plota mbi:

- Numrin e njësive bujqësore që do të përfshihen në census;
- Matjen e efektivitetit të përdorimit të këtyre të dhënave statistikore si në aspektin e brendshëm apo edhe atë të jashtëm nga përdorues të vëndeve anëtare të BE-së.
- Investimet potenciale që pritet të sjellë miratimi i kësaj politike dhe përdorimi i të dhënave statistikore në bujqësi.

Përlllogaritja e përfitimeve gjithashtu është e vështirë për shkak të mungesës së studimeve mbi potencialin e rritjes ekonomike dhe ndikimin në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Analiza sasiore e kostove dhe përfitimeve mund të kryhet vetëm pas miratimit të projektligjit dhe monitorimit të efektivitetit të tij në kohë. Vetëm atëherë do të jenë të disponueshme rregullat e detajuara dhe standardet specifike për sektorin privat dhe publik, të cilat do të mundësojnë një përlllogaritje të saktë të kostove dhe përfitimeve. Aktualisht, çdo analizë do të ishte spekulative dhe jo e bazuar në të dhëna të plota.

Ndikimi social i drejtpërdrejtë: Hartimi i projektligjit “Për Censin në Bujqësi” do të krijojë një bazë të të dhënave të plotë dhe të përditësuar për sektorin bujqësor, duke mundësuar planifikimin dhe zbatimin më efektiv të politikave kombëtare dhe në përputhje me standartet e BE-së. Ndikim i drejtpërdrejtë i Censurit është përmirësimin e bazës së të dhënave konrektisht në sektorin e bujqësisë.

Ndikim jo të drejtpërdrejtë: Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore do të jenë të tërthorta dhe varen nga mënyra se si të dhënat do të përdoren për të përmirësuar politikën, investimet, standartet dhe partneritetet tregtare.

Kosto fillestare në sektorin publik për të përmbushur normat dhe rregullat e reja ligjore për paisjen me teknologjitë, funksionimin e metodave që parashikon projektligji, zhvillimin e anketave, krijimi dhe mirëmbajtja e regjistrit statistikor por që investimet do të përkthehen në përfitime afatgjata si rritja e zhvillimit në bujqësi, ofrimi i bazës së të dhënave të sakta e reale të cilat shërbejnë në hartimet e politikave të duhura efektive, projekteve të investimeve, përfitimin ekonomik nga BE etj.

Code.	Përshkrimi i aktivitetit	Gjithsej				
		Njësi	Nr. i Njësie	Unit value (in EUR)	Costs (in EUR)	Kosto (in mln LEK)
1	Burimet njerëzore				4,581,013	475.49
1.1	Paga (përfshirë sigurimet shoqërore dhe kostot e tjera për stafin lokal)				4,302,113	446.54
1.1.1	Staf teknik (Anketues, Kontrollor, Teknik IT, GIS)	Muaj	8,409	480	4,039,313	419.27
1.1.2	Staf Mbështetës / Administrativë (Staf mbështetës për burime njerëzore, financë, ligjorë, prokurime)	Muaj	288	913	262,800	27.28
1.3	Dieta për misione/udhëtime	Për ditë	2,645	105	278,900	28.95
2	Shërbime udhëtimi dhe Monitorime				165,000	17.13
2.1.	Udhëtime Ndërkombëtare për rritje kapacitete				55,000	5.71
2.2.	Udhëtime për monitorim terreni / udhëtime për stafin e terrenit				110,000	11.42
3	Equipment and supplies				577,214	59.91
3.1.	Blerje / Marrje me qera e automjeteve	Muaj	60.0	1,400	84,000	8.72
3.2.	Pajisje, pajisje kompjuterike	Shërbim / Kompjuter			35,614	3.70
3.3.	Të tjera (IT hardware and software)	Licensë/ software/ shërbim			457,600	47.50
4	Zyra me qera				276,900	28.74
4.2	Hapësira për zyra me qera	Muaj	503	550	276,900	28.74
5	Shërbime vizibiliteti e të tjera				1,800,000	186.83
5.1.	Publikimi	Për shërbim	1	100,000	100,000	10.38
5.2.	Studime, kërkime, asistencë teknike	Ditë	1,150	863	1,057,500	109.76
5.3.	Expenditure verification/Audit		1	45,000	45,000	4.67
5.4.	Përkthime	Për faqe			30,000	3.11
5.5.	Konferenca / Seminars / Trajnime	Për ditë			327,500	33.99
5.6.	Aktivitet vizibiliteti	Për shërbim			240,000	24.91
6	Shpenzime të tjera				460,000	47.75
6.1.	Transport i materialeve të Cens (laptop, materiale...)				0	0.00
6.2.	Internet - wifi 100 Mb/s për gjithë zyrat e Cens, 3 months	Për shërbim	1	15,000	15,000	1.56
6.3.	Cloud (Cloud based service for data transfer and synchronisation)	Për shërbim			190,000	19.72
6.4.	Materiale të konsumueshme (çanta, stilolapsa, fletore, distinktiv etj)	Për shërbim			175,000	18.16
6.5.	Karburant për transport të materialeve të Cens	Për shërbim			80,000	8.30
7	Kosto të drejtpërdrejta, gjithsej (1-6)				7,860,127	815.85
8	Kosto indirekte (maksimumi 7% of 7, kostove të drejtpërdrejta)				314,405	32.63
9	Kostot direkte të pranueshme, gjithsej, duke përfshirë rezervën (7+ 8)				8,174,532	848.49
10	Parashikimi për rezervën e emergjencës (maksimumi 5% nga 7, nëntotali i kostove direkte të pranueshme)				408,727	42.42
11	Kosto gjithsej (9+10)				8,583,259	890.91

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni 1 - (rregullator): Ky opsion paraqet miratimin e një ligji të ri dhe shfuqizimin e Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësisve ekonomike bujqësore” duke dhënë zgjedhjen e duhur lidhur problematikat të cilat janë evidentuar. Ky opsion është i përshtatshëm, trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, duke dhënë rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë.

Përzgjedhja e këtij opsioni siguron që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standartet evropiane dhe në të njëjtën kohë përmbushin detyrimin për përafrimin e *acquis* së BE-së si dhe harmonizimin me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi.

Nga ana tjetër, ligji i ri mundëson rregullimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale duke patur parasysh statusin e ri të INSTAT-it si institucion publik i pavarur, në marrëdhënie me institucionet e tjera publike mbështetëse. Përmes propozimit të kësaj politike bëhet i mundur krijimi i një baze ligjore të konsoliduar për kryerjen e Censit të Bujqësisë, duke marrë në konsideratë standartet e reja ndërkombëtare të vendosura. Censi i Bujqësisë do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, në përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj, krijimin e regjistrit statistikor të

njësive ekonomike bujqësore dhe përgjithësimin e rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga EUROSTAT.

Siç e kemi shpjeguar edhe më lart janë identifikuar katër opsione, si më poshtë vijojnë:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së: Parashikon përqëndrimin në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma ligjore dhe që nënkupton mos dhënien e një zgjidhjeje problematikave të evidentuara, mos adresimin e tyre si dhe mos plotësimin e detyrimeve për përafrimin ligjor me s e BE-së.

Opsioni 1 - (rregullator): Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri dhe shfuqizimin e ligjit aktual, Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore” duke dhënë zgjedhjen e duhur lidhur problematikat të cilat janë evidentuar. Ky opsion është i përshtatshëm, trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, duke dhënë rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë.

Opsioni 2 - (rregullator): Sjell mundësinë e rishikimit të ndryshimeve ligjore në ligjin aktual Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, por nuk rregullon problematikat e evidentuara në fushën e mbledhjes së informacionit në bujqësi duke mos arritur rezultatet e duhura që synohen të arrihen sipas kërkesave të BE-së por edhe nevojave të evidentuara. Përzgjedhja e këtij opsion siguron që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standartet europiane dhe në të njëjtën kohë përmbushin detyrimin për përafrimin e s e BE-së si dhe harmonizimin me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit egzistues në fuqi nga strukturat kompetente. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, analizimi i terrenit më i shpeshtë etj.

Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këta sektorë. Ky opsion nuk ofron zgjedhjen e duhur për problematikat e evidentuara dhe as përmbushjen e qëllimeve që ka vënë Qeveria Shqiptare.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual, Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore” është opsioni i preferuar sepse ofron zgjedhjen e duhur lidhur problematikat të cilat janë evidentuar. Ky opsion është i përshtatshëm, trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh problematike në kohë, duke dhënë rezultatet e duhura në raport objektivat që Qeveria synon të përmbushë.

Përmes propozimit të kësaj politike bëhet i mundur krijimi i një baze ligjore të konsoliduar për kryerjen e Censit të Bujqësisë, duke marrë në konsideratë standardet e reja ndërkombëtare të vendosura. Parashikimi i një kornizë legjislative unike për të gjithë sektorin e statistikave bujqësore në rang europian e cila përcakton objektiva dhe përkufizime të përbashkëta bën të mundur specifikimin e rezultateve të kërkuara statistikore në nivel të përgjithshëm, përkatësisht të çdo nënfushe të statistikave bujqësore. Kjo do të mundësojë harmonizimin e plotë legjislativ, përditësimit e vazhdueshëm të statistikave bujqësore dhe do të rrisë besimin e përdoruesve duke marrë produktin që i përgjigjet nevojave të tyre me cilësisë maksimale (për shkak të koherencës, qartësisë, besueshmërisë, saktësisë dhe në kohë).

Censi i Bujqësisë do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, në përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj, krijimin e regjistrit statistikor të njësive ekonomike bujqësore dhe përgjithësimin e rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga EUROSTAT. Shtrirja e statistikave bujqësore mund të zgjerohet në të ardhmen duke përfshirë aspekte të pylltarisë, peshkimit, mbulimit dhe përdorimit të tokës dhe të ujit, si çështje të lidhura mes tyre nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor. Për më tepër, të dhënat statistikore brenda Sistemit të Statistikave Bujqësore Europiane duhet të prodhohen dhe t'i transmetohen Eurostatit në mënyrën më efektive duke reduktuar hapat e ndryshëm të procesit pa ulur cilësinë e të dhënave. Pjesë e rëndësishme e kësaj është konfirmimi nëse të dhënat statistikore përputhen me standartet e kriterëve specifike. Mënyra se si janë zhvilluar statistikat bujqësore gjatë viteve nuk e ka bërë ende të mundur që të thjeshtohet vërtetimi i transmetimit të të dhënave në EUROSTAT.

Ndërkohë, miratimi i kësaj politike që propozojmë është i domosdoshëm për të siguruar kryerjen e aktivitetit “Censi i bujqësisë”, parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026, miratuar me Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026”.

Opsioni i për zgjedhur nga ana jonë parashikon investime fillestare të konsiderueshme, por pritshmëritë për ndikime afatgjata janë të larta dhe me rezultate pozitive sociale, ekonomike dhe mjedisore duke justifikuar kështu kostot.

Rritja ekonomike dhe përmbushja e standardeve të BE-së pritet të kenë një ndikim pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të vendit më gjerë, duke mbështetur kështu edhe objektivat kombëtare për integrim europian dhe mirëqenie të shtuar për shoqërinë.

Për rrjedhojë, **Opsioni 1** do të ketë një ndikim pozitiv në përfitueshmërinë dhe rritjen ekonomike të sektorëve të përfshirë.

Në vijim të arritjes së synimit përfundimtar për përzgjedhjen e Opsionit 1 si opsioni i preferuar nga ana jonë është kryer analiza me shumë kriterë e cila ka disa hapa siç janë përcaktimi i kriterëve, vendosja e peshës etj.

Risite që sjell që sjell kjo nismë ligjore janë:

1. Ofrimi i të dhënave të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor në Republikën e Shqipërisë;
2. Marrja e masave të nevojshme për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe metodatave të transmetuara në mënyrë që kriteret e cilësisë statistikore të jenë në përputhje me parimet statistikore të përcaktuara në legjislacionin për statistikat zyrtare;
3. Aksesimi i INSTAT në listën e plotë të pronarëve të tokës, sipërfaqen në pronësi dhe adresat e vendndodhjes së tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
4. Nisma ligjore ngarkon INSTAT-in, të tij për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve për kundërvajtjet administrative të konstatuara, në respektim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjit për kundërvajtjet administrative.

Rezultatet e pritshme nga miratimi i kësaj nisme ligjore janë:

1. Harmonizimi në metodologjinë e llogaritjes së treguesve, klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të EU-së;

2. Ridizenjimi i pyetësorit të vrojtimit vjetor në bujqësi (njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale), si dhe përgatitja e kampionit të veçantë për bujqësinë dhe blegtorinë me qëllim rritjen e cilësisë;
3. Përdorimi i metodave të kombinuara të grumbullimit të informacionit statistikor nga vrojtimi dhe burimi administrativ lidhur me të dhënat për numrin e krerëve dhe prodhimet blegtorale, si dhe regjistrin administrativ të kafshëve;
4. Llogaritja e treguesve të rinj bazuar në rregulloren evropiane të statistikave të blegtorisë dhe prodhimit të mishit, si: therjet jashtë thertoreve, prodhimi i brendshëm bruto (parashikimi i mishit) etj.;
5. Rishikimi dhe pasurimi i listës së prodhimeve bujqësore domethënëse për llogaritjen e indeksit të çmimeve të prodhimeve bujqësore;
6. Rishikimi dhe pasurimi i listës së prodhimeve bujqësore domethënëse për llogaritë ekonomike në bujqësi;
7. Llogaritja e indikatorëve në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
8. Zhvillimi i Cens-t të Bujqësisë.

Vendosja e peshës së kritereve sipas rëndësisë relative.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtme:

1. Përcaktimi i kritereve që tregojnë arritjen e objektivit:

- Efektiviteti i sigurimit të informacionit të përgjithshëm dhe të hollësishëm për 98% të sipërfaqes së shfrytëzuar nga njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale, në territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe 3 vjeçare nga momenti i miratimit i nismës;
- Efektiviteti në ofrimin e qartësisë dhe kuptueshmërisë juridike;
- Efektiviteti në krijimin e një regjistri statistikor i njësive ekonomike bujqësore në një periudhë prej 2 vitesh nga momenti i miratimit të kësaj nisme;
- Efektiviteti në përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire* të BE-së menjëherë me miratimin e kësaj nisme ligjore;
- Kosto - efektiviteti.

2. Vendosja e peshës sipas kritereve sipas rëndësisë relative

- Efektiviteti i sigurimit të informacionit të përgjithshëm dhe të hollësishëm për 98% të sipërfaqes së shfrytëzuar nga njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale, në territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe 3-vjeçare nga momenti i miratimit i nismës - 5;
- Efektiviteti në ofrimin qartësisë dhe kuptueshmërisë - 5;
- Efektiviteti në përditësimin e regjistri statistikor të njësive ekonomike bujqësore në një periudhë prej 2 vitesh nga momenti i miratimit të kësaj nisme - 4;
- Efektiviteti në përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire* të BE-së menjëherë me miratimin e kësaj nisme ligjore - 4;
- Kosto - efektiviteti - 4.

Për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra - tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1 - 5. Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së

preferencës për çdo opSION për secilin kriter nga 0 - 5 ku 0 përfaqëson opSIONIN më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës: Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
		Pikë	Vlera (= Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
1. Efektiviteti i sigurimit të informacionit të përgjithshëm dhe të hollësishëm për 98% të sipërfaqes së shfrytëzuar nga njësitet ekonomike bujqësore dhe blegtorale, në territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe 3 vjeçare nga momenti i miratimit i nismës-5;	5	1	5	5	25	4	20	2	10
2. Efektiviteti në ofrimin e qartësisë dhe kuptueshmërisë juridike -5;	5	1	5	5	25	4	20	1	5
3. Efektiviteti në krijimin e një regjistri statistikor i njësive ekonomike bujqësore në një periudhë prej 2 vitesh	4	0	0	4	16	4	16	0	0

nga momenti i miratimit të kësaj nisme-4-									
4. Efektiviteti në përafrimin e legjislacionit me acquis commnautaire të BE-së menjëherë me miratimin e kësaj nisme ligjore-5;	4	0	0	4	16	4	16	0	0
Kosto-efektiviteti	4	1	4	4	16	3	12	2	8
Pikët totale për secilin option			14		98		84		23

Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni 1 (miratimi i projektligjit të ri “Për Censin në Bujqësi”) është vlerësuar me më shumë pikë dhe është zgjedhur si opsioni i preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Në Shqipëri, institucionet dhe organet e ngarkuara nga ligji me zbatimin dhe monitorimin e ligjit “Për Censin e Bujqësisë” janë siç vijon:

- INSTAT-i,
- Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë;
- Komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie,
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e mbledhjes së informacionit statistikor në bujqësi. Si autoriteti kompetent qendror MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore të në varësi të saj përmes së cilave ajo informohet në kohë reale për monitorimin në terren dhe zbatimin e ligjit. Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor përkatësisht do të monitorojë dhe raportojë nga terreni si autoriteti përgjegjës. Në kuadër të arritjes së objektivave të institucionit në MBZHR është ngritur dhe funksionon njësi përgjegjëse për statistikën Drejtoria e Statistikave, Analizës dhe Raportimeve. DSAR kryen këto funksione:

1. Prodhon informacion të saktë dhe koherent për të mbështetur analizat efektive dhe vendimet e politikëbërjes nga MBZHR.

2. Mbledh, përpunon dhe prodhon indikatorët statistikor vjetor në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë të cilat publikohen në faqen zyrtare të INSTAT.
3. Grumbullon dhe përpunon informacion statistikor të ardhur nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për indikatorët në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agroindustrisë.
4. Kryen vrojtime të ndryshme për grumbullimin e informacionit, përpunimin e të dhënave në lidhje me treguesit statistikor bujqësor për t'iu përgjigjur kërkesave gjithmonë në rritje nga përdoruesit, në bashkëpunim me INSTAT, me fokus edhe përditësimin e Regjistrit të Fermës.
5. MBZHR marr të gjitha masat për ngritjen e rrjetit të kontabilitetit të fermës (FADN), duke krijuar edhe një sektor të posaçëm, konkretisht FADN-së në Drejtorinë e Statistikave, Analizës dhe Raportimeve.

- **Instituti i Statistikave (INSTAT)** ka këto përgjegjësi:

Regjistri statistikor i njësive ekonomike bujqësore i cili do të administrohet dhe mirëmbahet nga INSTAT¹³ do të pasurohet me të dhëna të cilat do të mbledhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare, si edhe sipas standardeve dhe rekomandimeve të Eurostatit dhe të Kombeve të Bashkuara për censet e bujqësisë.

Ky regjistër do të jetë një burim autentik, i besueshëm, zyrtar që ofron të dhëna statistikore për të gjithë palët e interesuara në të njëjtën lartësi si edhe sisteme të tjerë statistikore europiane për të dhënat në bujqësi si p.sh. *Coba & Cogeca* që është bashkësia europiane e fermerëve e që ofrojnë një burim të të dhënash në fushën e bujqësisë¹⁴. Një tjetër burim zyrtar i të dhënave europiane është EUROSTAT që është zyra statistikore e BE-së duke ofruar të dhëna për të gjitha politikat e vendeve anëtare¹⁵.

- a) Përcakton ditën e censit, harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen e zbatimit të censit në baza profesionale dhe shkencore;
- b) Menaxhon burimet njerëzore dhe financiare përkatëse dhe informon Komisionin Qendror të Censit të Bujqësisë dhe donatorët ndërkombëtarë mbi përdorimin e këtyre burimeve;
- c) udhëzon komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie, të ngritura sipas parashikimeve të nenit 19 të këtij ligji, për detyrat që kanë për mbështetjen e censit;
- ç) u propozon autoriteteve publike përkatëse hapat që duhen ndërmarrë për censin e bujqësisë;
- d) zhvillon fushatën për informimin e publikut;
- dh) kryen procedurat e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe trajnimit të stafit të terrenit me mbështetjen, sipas nevojës, komisioneve të censit të bujqësisë në nivel bashkie;
- e) drejton punën për realizimin e censit të bujqësisë në të gjitha fazat, në bashkëpunim me institucionet dhe organet mbështetëse të censit të bujqësisë;
- ë) përpunon të dhënat e mbledhura nga censi i bujqësisë dhe ndërmerr masat e duhura për mbrojtjen e konfidencialitetit të tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 13 të këtij ligji;
- f) paraqet e boton rezultatet përfundimtare të censit në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;

¹³ Neni 2 i projektligjit “Qëllimi i Censit të Bujqësisë”.

¹⁴ Agrobiznesi/Bujqësia/Blegtoria (COPA- COGECA): <http://www.copa-cogeca.be>

¹⁵ <https://ec.europa.eu/eurostat>

- g) i raporton Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë ecurinë e aktiviteteve të censit;
- gj) kryen detyrën e sekretariatit të Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë dhe ka këto detyra:
 - i. njofton anëtarët e Komisionit për mbledhjen e radhës;
 - ii. mban procesverbalin e mbledhjes;
 - iii. përgatit dokumentacionin bazë të mbledhjes, të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes.

2. Për kryerjen e suksesshme të censit të bujqësisë dhe për të garantuar zbatimin e parimeve statistikore sipas legjislacionit për statistikat zyrtare, INSTAT-i ka të drejtë të ndërmarrë çdo aktivitet tjetër të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Monitorimi i zbatimit të ligjit sipas kompetencave e ka INSTAT i cili gjatë përmbushjes së detyrave të tij edhe monitoron procesin. INSTAT është përgjegjës edhe për shqyrtimin, verifikimin, marrjen e vendimeve dhe ankimin për kundërvajtjet administrative të konstatuara, në respektim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjit për kundërvajtjet administrative.

Projektligji në parashikimin e tij për personelin e INSTAT ka caktuar punësimin e mbikëqyrësve, të cilët menaxhojnë, mbështesin dhe raportojnë punën e kontrollorëve të varësisë.

- ***Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë*** ka këto përgjegjësi:

- a) Harton dhe miraton rregulloren e Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë;
- b) Ndjek përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë dhe mbështet INSTAT-in për të siguruar furnizimin me të dhëna nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile;
- c) Lehtëson bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve publike e shkencore për mbështetjen e censit;
- ç) Miraton projektkalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë, i cili përgatitet nga INSTAT-i;
- d) Shqyrton çdo kërkesë të paraqitur dhe lëshon autorizim të veçantë në lidhje me miratimin për mbledhjen e informacionit nga publiku gjatë periudhës prej 4 javësh, përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave të censit, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

Monitorimi i zbatimit të ligjit sipas kompetencave të sipërcituara e ka vet Komisioni i cili gjatë përmbushjes së detyrave të tij edhe monitoron procesin.

- ***Komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie*** kanë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) Mbështesin INSTAT-in në organizimin e punës të censit të bujqësisë në zonat e numërimit, brenda juridiksionit përkatës të bashkisë;
- b) Ndihmojnë INSTAT-in në përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve që do të përdoren gjatë fushatës së informimit;
- c) Ndihmojnë INSTAT-in gjatë procesit të rekrutimit për punonjës terreni;
- ç) I sigurojnë dhe vënë në dispozicion të personelit të censit ambiente të nevojshme për të mbështetur proceset e censit sipas kërkesave të INSTAT-it dhe/ose Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë;

- d) Mbështesin INSTAT-in për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë procesit të censit të bujqësisë;
- dh) I raportojnë periodikisht INSTAT-it, dhe sipas kërkesës së këtij të fundit, për ecurinë e përmbushjes së detyrave të parashikuara në këtë nen.

Monitorimi i zbatimit të ligjit sipas kompetencave të sipërcituara e kanë komisionet i cili gjatë përmbushjes së detyrave të tij edhe monitoron procesin.

Pengesat e mundshme gjatë zbatimit të opsionit të zgjedhur mund të jenë:

1. Vonesat në zbatimin e legjislacionit nga ana e institucioneve e tjera ligjzbatuese, mungesa e teknologjisë sipas kërkesave për përdorimin e metodave të caktuara, vonesa në procesin e anketimit etj.
2. Një pengesë tjetër e mundshme mund të jetë mungesa e trajnimit të nevojshëm magësi në monitorimin zbatimin e standarteve të reja nga ana e strukturave mbikëqyrëse.
3. Vonesë në ngritjen dhe funksionimin e regjistrit statistikor të njësive ekonomike bujqësore. Pengesa mund të jetë e natyrës funksionale ose e natyrës financiare.
4. Institucionet mund të kenë vështirësi në përshtatjen e praktikave të tyre me standardet specifike të BE-së, të metodikave të përdorura për vjeljen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, për shkak të mungesës së përvojës ose ekspertizës teknike.

Të gjitha këto mund të vonojnë efektet e pritshme pozitive të ligjit, por gjithsesi nuk e ndalin zbatimin e tij të plotë në të ardhmen.

Disa nga masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës janë:

- Gatishmëria administrative për të trajnime dhe mënyra të tjera reklamimesh të informacionit mbi këto metoda për t'i bërë ato të njohura dhe për nxitjen e besimit të publikut nga rregullimeve të reja ligjore.
- Gatishmëria institucionale për të ofruar asistencë gjatë zbatimit të ligjit për sektorin privat.
- Dhënia e mundësisë për paraqitjen e mendimeve të sektorit publik/privat lidhur me risitë e projekligjit si gjatë procesit të konsultimit të projekaktit me përfaqësues të sektorit privat po edhe gjatë takimeve të ndryshme të zhvilluara lidhur me qëllimin e njohjes së tij.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Për të kryer një monitorim sa më efikas të zbatimit të projektligjit do të përdoret informacioni i mëposhtëm:

1. Numri i përdoruesve të të dhënave statistikore të përpunuara sipas parashikimeve të këtij ligji, 1 vit pas hyrjes në fuqi të ligjit.
2. Sa janë përdorur nga të investitorët e huaj, nëse ky informacion është i mundur, apo baza të tjera të të dhënash si psh EUROSTAT të dhënat e ofruara;

3. Të dhëna mbi sa të sukseshme kanë qënë në zbatim të dhënat e ofruara dhe sa janë përdorur për parashikime, strategji, investime nga përdoruesit gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre;
4. Sa herë i janë referuar këtyre të dhënave mediat, OJF, OJQ etj. gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre;
5. Treguesit e performancës, që ndihmojnë në matjen e progresit në krahasim me objektivat e vendosura;
6. Vlerësimi i riskut, i cili identifikon rreziqet dhe përcakton prioritetet për veprime të ardhshme.

Për të matur arritjen e objektivave të programeve të çrrënjësjes dhe për të siguruar një proces të efektshëm monitorimi, kriteret e matjes duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë (SMART).

Më poshtë paraqiten disa prej tyre:

1. Numri i fermerëve që përdorin të dhënat statistikore në vitin e parë pas miratimit të projektligjit;
2. Numri i përdoruesve sipas grupeve të identifikuara¹⁶, gjatë vitit të parë pas miratimit të projektligjit;
3. Numri i vendeve të reja të punës të krijuara në sektorin bujqësor në raport me impaktin e këtij projektligji;
4. Niveli i investimeve në këtë sektor krahasuar me periudhën përpara miratimit të projektligjit:
 - Referuar projektligjit të gjitha funksionet monitoruese, kontrolluese dhe mbikqyrëse për fillimin zhvillimin dhe përfundimin e censurit në bujqësi kryhen nga INSTAT. Po kështu INSTAT, sipas këtij projektligji, ka të drejtën të ndërmarrë masa administrative në rast të konstatimit të shkeljeve të dispozitave ligjore.
 - Ministria përgjegjëse për bujqësinë ka përgjegjësi bashkëpunimin dhe vënien në dispozicion të Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë të dhëna dhe burime për lehtësimin e veprimtarive të censit, sipas kërkesës së këtij organi.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<i>Faktori zbritës</i>										
Kosto për buxhetin – njëherë	890									
Kosto për buxhetin – në vazhdim										

¹⁶ Shih faqe 14.

Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	890									
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi I zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total	890									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-890									

Sipas vlerësimit të kryer nga INSTAT, kostot e parashikuara për realizimin e Censurit në Bujqësi – një proces që zhvillohet një herë në çdo 10 vjet – arrijnë në një total prej 890.91 milion lekësh. Kjo shumë është e shpërndarë sipas zërave kryesorë të nevojshëm për organizimin dhe zbatimin e tij.

Shpenzimet gjithsej të parashikuara për cens të njësive ekonomike bujqësore vlerësohen 890.91 mln lekë.

Treguesit kryesor të projektbuxhetit janë:

- Detyrimet për pagesën e burimeve njerëzore paraqiten në vlerën 475.49 mln lekë dhe përbën rreth 53 % të shpenzimeve gjithsej të parashikuara. Këtu përfshihen shpenzimet për paga të stafit teknik: Anketues, Kontrollor, Specialistë IT në suport të procesit, GIS dhe staf mbështetës për burime njerëzore, financë, ligjorë dhe prokurime.
- Shpenzimet për shërbime udhëtimi dhe monitorime llogariten në vlerën 17.13 mln lekë. Fond i parashikuar ky në mbështetje të realizimit të procesit të trajnimeve dhe monitorimeve, gjatë kryerjes së vërtetimit në terren.
- Shpenzimet për paisje dhe furnizime shpenzime përbëhen kryesisht nga shpenzimet për marrje me qera të makinave të nevojshme për procesin e monitorimit në terren si dhe pajisjeve kompjuterike, të nevojshme për stafin dhe vlerësohen në shumën prej 59.91 mln lekë.
- Ky projekt buxhet parashikon gjithashtu shpenzimet për zyra me qera, ku përfshihen kryesisht shpenzimet për marrje me qera të ambjenteve për kryerjen e trajnimeve apo zyrave që do jenë në funksion të stafit gjatë periudhës së zhvillimit në terren të Cens. Ky komponent llogaritet në vlerën 28.74 mln lekë.
- Rreth 21 % të shpenzimeve të parashikuara e përbëjnë shpenzimet për shërbime vizibiliteti e të tjera, të llogaritura në vlerën e 186.83 mln lek. Këtu përfshihen kryesisht shpenzime për fushatë publicitare, organizim konference, publikimet, asistencë teknike, etj.
- Shpenzime të tjera, të parashikuara kryesisht për internet cloud si dhe për karburant për transportin gjatë periudhës së censusit. Këto shpenzime llogariten në vlerën 47.75 mln lekë.

Kostot e drejtëpërdrejta gjithsej vlerësohen 815.85 mln lekë.

- Kosto indirekte (max 7% e kostove të drejtëpërdrejta) në vlerën 32.63 mln lekë dhe parashikim për rezervën e emergjencës (max 5% e kostove të drejtëpërdrejta) në vlerën 42.42 mln lekë.

Raporti i vlerësimit të ndikimit – Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milion lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	890		-890
Opsioni 2			